



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

BULETINI I PRAKTIKËS GJYQËSORE
(MENDIMET MOSPAJTUESE)

BILTEN SUDSKE PRAKSE
(MIŠLJENJA NESLAGANJA)

BULLETIN OF CASE LAW
(DISSENTING OPINIONS)

МАНКЕМЕ İÇTİHATLARI BÜLTENİ
(KARŞI OY YAZILARI)

2009-2010



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

BULETINI I PRAKTIKËS GJYQËSORE
MENDIMET MOSPAJTUESE
2009-2010

Botues:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës

Bordi redaktues:

Prof.Dr. Enver Hasani, Kryetar i Gjykatës Kushtetuese

Almiro Rodrigues, Gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese

Prof.Dr. Snezhana Botusharova, Gjyqtare e Gjykatës Kushtetuese

Prof.Dr. Ivan Čukalović, Gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese

Mr.Sc. Arbëresha Raça-Shala, Sekretare e Përgjithshme e Gjykatës Kushtetuese

Dastid Pallaska, Redaktor ekzekutiv

Përgatitur nga:

Sekretaria e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës

© 2011 Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës

Të drejtat e autorit:

Asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet apo transmetohet në çfarëdo forme apo përmes çfarëdo mjetesh, elektronike apo mekanike, duke përfshirë fotokopjimin dhe incizimin, apo ruajtjen në sisteme ripërdorimi, pa lejen paraprake me shkrim nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, përveç nëse një kopjim i tillë në mënyrë të qartë lejohet nga ligji përkatës për të drejtat e autorit.

Përjashtim i përgjegjësive:

Sipas nenit 116.4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, vendimet e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës botohen në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, e cila është burim primar për vendimet e Gjykatës Kushtetuese. Ky Buletin nuk zëvendëson burimin primar për vendimet e Gjykatës Kushtetuese. Në rast të ndonjë konflikti apo mospërputhje në mes të vendimeve të botuara në këtë Buletin dhe vendimeve të botuara në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, mbizotëron versioni i botuar në Gazetën Zyrtare.

Qëllimi i përmbledhjes së vendimeve është për të dhënë një pasqyrë të përgjithshme faktike dhe juridike të rasteve dhe një përmbledhje të shkurtër të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese. Si e tillë, përmbledhja e aktgjykimeve nuk zëvendëson vendimet e Gjykatës Kushtetuese, dhe nuk përfaqësojmë formulimin e vërtetë të aktgjykimeve të Gjykatës Kushtetuese.

**BULETINI
I PRAKTIKËS GJYQËSORE
(MENDIMET MOSPAJTUESE)
2009-2010**

Përmbajtja:

Parathënie.....	7
Rasti KI 11/09, Tomë Krasniqi vs RTK dhe KEK Mendimi mospajtuës rreth masave të përkohshme ¹ Gjykatësi AlmiroRodrigues.....	9
Lënda KI 11/09, Tomë Krasniqi vs RTK-në dhe KEK-u Mendim mospajtuës për masën e përkohshme Gjyqtarja Dr. Gjyljeta Mushkolaj	27
Mendim konkurrues Gjyqtar Almiro Rodrigues Aktgjykimi në rastin nr. KO 01/09.....	31
Opinion i përbashkët mospajtuës i gjyqtarit Almiro Rodrigues dhe gjyqtarës Snezhana Botusharova Lënda nr. KI 47/10 Naim Rustemi dhe 31 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës vs. Shkëlqesisë së Tij, Fatmir Sejdiu, President i Republikës së Kosovës	36
Rasti Nr. KO 29/11 Parashtrues Sabri Hamiti dhe deputetë të tjerë të Kuvendit të Kosovës Vlerësim i kushtetutshmërisë të Vendimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr. 04-V-04 Lidhur me zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës të 22 shkurtit 2011 30 mars 2011 Mendim mospajtuës i gjyqtarëve Robert Carolan dhe Almiro Rodrigues	47
MENDIM MOSPAJTUES në Rastin Nr. KI 55/09 Parashtrues N.T.SH. Meteorit Vlerësim i kushtetutshmërisë të Vendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Nr. 2407/2006, të 30 shtatorit 2009 Gjyqtarët Almiro Rodrigues dhe Gjyljeta Mushkolaj.....	53

Parathënie

Mund të themi se një vend është demokratik dhe i përkushtuar ndaj sundimit të së drejtës vetëm atëherë kur drejtësia administrohet në mënyrë publike, kur gjykatat shqiptojnë vendimet dhe aktgjykimet e tyre në mënyrë të hapur dhe pa u frikësuar dhe kur ato vendime dhe aktgjykime u vihen në dispozicion qytetarëve. Kjo shërben jo vetëm për informimin e palëve përkatëse për rezultatin përfundimtar të secilit rast, por njëkohësisht edhe për të njoftuar qytetarët se si gjykata ka ardhur deri tek ai vendim. Prandaj edhe arsyet dhe parimet në cilat gjykata mbështet vendimet e saj bëhen të njohura për të gjithë. Përfitimet nga kjo përfshijnë parimin e sigurisë ligjore që është shumë i rëndësishëm për zhvillimin e afarizmit publik dh privat. Në anën tjetër kjo shton besimin në administrimin e drejtësisë.

Pas marrjes së vendimeve, sa më shpejtë që është e mundur Gjykata Kushtetuese e Kosovës ua dërgon palëve në procedurë dhe i boton në Gazetën Zyrtare dhe në faqen e saj të internetit. Tani, përveç këtyre Gjykata ka kënaqësinë të prezantojë edhe Buletinin e parë të përmbledhjes së aktgjykimeve. Ky Buletin përmban të gjitha lëndët për të cilat Gjykata ka nxjerrë vendimet që nga inaugurimi i saj e deri më janar 2011. Lexuesve iu tërheq vëmendjen të shikojnë përmbledhjet e lëndëve që i kemi përfshirë para secilit Vendim. Në këto përmbledhje mund të mësoni për pasqyrën e përgjithshme të fakteve, kornizën ligjore dhe vendimin pa pasur nevojë të lexoni tërë Vendimin.

Për qëllim të lehtësimit të përdorimit dhe kërkimit të vendimeve, Buletini është i aranzhuar ashtu që fjalët kryesore gjenden në indeks, ndërsa në fund ekziston edhe indeksi i neneve të Kushtetutës.

Gjykata shpreson se si ky, ashtu dhe botimet e ardhshme të Buletinit të përmbledhjes së aktgjykimeve do t'u ndihmojnë Gjyqtarëve, ligjvënësve, juristëve, akademikëve, studentëve dhe qytetarëve në përgjithësi në studimin dhe zhvillimin e jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese.

Prof. Dr. Enver Hasani
Kryetar i Gjykatës Kushtetuese

Rasti KI 11/09, Tomë Krasniqi vs RTK dhe KEK

Mendimi mospajtures rreth masave të përkohshme¹ Gjykatësi Almiro Rodrigues

Hyrje

1. Me respekt, ne nuk mund të pajtohemi me vendimin e shumicës rreth masave të përkohshme në asnjë pikëpamje; as në atë procedurale e as në atë formale. Përkundrazi, konkludojmë se masat e përkohshme nuk duhen vendosur para se të pranohet rasti dhe kërkesën për masa të përkohshme nuk duhet hedhur poshtë tërësisht si të pa bazë.
2. Duam të theksojmë në fillim se kundërshtimi ynë rrjedh vetëm si rezultat i mospajtit tonë me konkludime të besueshme juridike të shumicës. Është e padiskutueshme se shumica ka arritur konkludimin në mënyrë të ndershme, haptazi dhe në përputhje të plotë me etikën dhe obligimet profesionale të gjykatësve të Gjykatës Kushtetuese. Prandaj, derisa e shprehim kundërshtimin tonë, e bëjmë këtë me respekt dhe me besim të plotë në ndershmërinë tonë të padiskutueshme të vendimit të shumicës.
3. Duam të theksojmë gjithashtu se kundërshtimi ynë lidhet vetëm me çështjet ligjore, por jo me ato të faktit. Është evidente se në vendimmarrje rreth vlerave të masave të përkohshme, shumica nuk tregon të gjetura faktike. Në këtë mospajtim asgjë nuk duhet të lidhet me konkludime faktike. Më saktë, ne vetëm e kemi rishikuar hapin procedural të bllokimit të kërkesës publike dhe arsyeshmërinë rreth

¹ Shënime paraprahe

Vendimi mbi masat e përkohshme në rastin KI 11/09, Tomë Krasniqi vs RTK dhe KEK është i pari të inicohet nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës. Në këtë mënyrë, është vendosmërisht me rëndësi jo vetëm për qytetarët e Kosovës por gjithashtu edhe për të drejtën procedurale për t'u mbështetur nga gjykata. Këto rrethana të dhëna dhe duke mos u pajtuar, ne ishim shumë të zënë dhe ju sqarojmë tërësisht arsyen që nuk mundëm t'i bashkohemi shumicës në atë moment madhështor Menduam se do të jemi të bezdisshëm për personat të cilët rastësisht kanë mundësinë të ballafaqohen me mendimin tonë mospajtures. Prapë se prapë, ne dhamë përpjekjet tona shtesë në emër të mbështetjes së Kushtetutës, duke kryer punën time me përgjegjësi individuale dhe të pavarur dhe duke dhënë këtë kontribut modest për një debat të hapur, produktiv dhe të respektuar, që shpresoj se do të jetë i dobishëm.

vendimmarrjes së masave të përkohshme, pa dhënë asnjë mendim për vërtetësinë e deklaratës rreth rastit të tillë ose kërkesës për masa të përkohshme.

4. Në këtë mënyrë, duke marrë parasysh bazën faktike e sjellë nga palët, ne do ta analizojmë dhe diskutojmë kryesisht hapin procedural për të mbajtur një dëgjim publik dhe pranueshmërinë e rastit (I) dhe vlerat e masave të përkohshme (II).

I. Hapi procedural i mbajtjes së një dëgjimi publik dhe prezantimi i rastit

5. Struktura procedurale e këtij rasti e zbatuar nga shumica dhe çështja (si objekt i këtij kundërshtimi) është shprehur në parathënien e vendimit të shumicës. Kjo tregon se pas dëgjimit të procesverbalit të gjykatësit (...) që e ka shtjelluar çështjen në tërësi me maturi, dhe si shkas është "kërkesa e 2 shtatorit 2009" për imponimin e masave të përkohshme për rastin KI 11/09 e klasifikuar nga Tomë Krasniqi kundër RTK et AI "
6. Gjatë analizimit dhe diskutimit të hapit procedural të vendimit të shumicës mbi masat e përkohshme, interpretimin e këtij hapi të dëgjimit publik dhe pranueshmërisë së rastit e bëjmë së bashku, por analizimi i këtyre artikujve do të bëhet ndarazi .

1. Hapi procedural i dëgjimit publik

7. Më 2 shtator 2009, Tomë Krasniqi ka kërkuar masa të përkohshme duke pohuar se "inkasimi i shumës prej 3,5 eurove i shkel në mënyrë të ashpër të drejtat e qytetarëve dhe interesin publik. Kështu që ai kërkoj të pezullohet zbatimi i kësaj marrëveshje deri në një vendimmarrje që bazohet në vlera.
8. Më 02.03.2009, ai e filloi tërë këtë proces me kërkesën e tij ndaj KEK-ut për shkak të "rrethanave të vështira" nën të cilat ai jeton, ku për këtë arsye ai nxori si përfundim se "nuk ishte e drejtë (...) të paguhen shpenzimet e energjisë elektrike dhe të vazhdojë të jetojë me 40 euro në muaj". Ai, edhe më tutje, deklaronte se "është absurde, jonormale dhe shumë e pamoralshme për një pensionist të Kosovës që të paguajë 3, 5 euro në muaj për Radiotelevizionin e Kosovës.

9. Dëgjimi publik për masat e përkohshme të kërkuara është caktuar dhe është mbajtur më 6 tetor 2009 pa ndonjë vendim mbi pranueshmërinë e rastit që është bërë më parë. Ta përkujtojmë se dëgjimet nuk janë normative në procedurat e Gjykatës Kushtetuese, që, në përgjithësi, vetëm rastet e pranuar "mund të bëhen objekt i dëgjimit"² Por, kur kemi të bëjmë me masat e përkohshme, "Kryetari vet e cakton datën e dëgjimit sa më shpejt që është e mundur e cila do t'iu jap mundësi palëve që në kërkesë t'i shprehin pikëpamjet e tyre³ Me këtë duket se dëgjimi mbi masat e përkohshme është normativ.
10. Çështja, që tani është duke u marrë në konsideratë, është ose jo rast *ex-officio* i Gjykatës Kushtetuese ose rasti i një pale që përkohësisht mundë të vendoset për masat e përkohshme pa e pranuar atë për të cilin ajo është e lidhur.

2. Pranueshmëria e rastit

11. Pranueshmëria, tani për tani, nuk është çështje kryesore. Megjithatë, sipas kornizës ligjore kushtetuese, është vështirë, e të mos thuhet e pamundur, të diskutohen masat e përkohshme së paku pa e shqyrtuar në mënyre të përgjithshme pranueshmërinë, për shkak se, sipas mendimit tonë, nuk ka procedurë për ' masat e përkohshme, këtu mendohet pa e pranuar rastin korrespondent.
12. Ende mendojmë se vendimi për pranueshmërinë e rastit duhet të merret para se të bëhet procesimi i masave paraprake. Në fakt, korniza ligjore kushtetuese tregon se "Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për çështjet që i dërgohen gjykatës në mënyrë legale nga palët e autorizuara"⁴; në mënyrë më specifike konstaton se "inicimi i procedurave pranë Gjykatës Kushtetuese bëhet përmes rastit të paraqitur në këtë gjykatë"⁵;

² Paragrafi 37 (2) i Rregullores së Procedurave

³ Paragrafi 52 (2) i Rregullores së Procedurave

⁴ Neni 11 3 i Kushtetutës

⁵ Neni 22i Ligjit mbi Gjykata

"Gjykata Kushtetuese e pranon dhe e proceson rastin (...) nëse vlerësohet se është në përputhje me të gjitha kërkesat legjitime"⁶, dhe, në fund, vetëm rastet që nuk janë lënë anash, duke u bazuar në papranueshmërinë e tyre, mundë të bëhen si objekt i dëgjimeve"⁷, që është e njëjtë sikur të thuhet se rastet e pranuar mundë të bëhen objekt i dëgjimeve.

13. Sipas mendimit tonë, interpretimi i këtyre dispozitave ligjore është i qartë dhe pa dyshim i lidhur me konceptin që ato e shprehin. Gjithashtu, janë konsistente me veçoritë kyçe të procedimit ku gjykatësi raportues i propozon kolegjit shqyrtues⁸ i cili ia parashtron gjykatës (të gjithë gjykatësve)⁹ një draft vendim mbi pranueshmërinë¹⁰. Në fund , interpretimi i propozuar arsyetohet me qëllim të shmangies nga një situatë të mundshme absurde ku është marrë vendim mbi masat e përkohshme lidhur me rastin, i cili më vonë është konsideruar si i papranueshëm ose të merret vendim mbi masat e përkohshme lidhur me rastin që asnjëherë nuk është pranuar.
14. Interpretimi sistematik, i saktë ose teleologjik na shpie kah një konkludim imponues se pranueshmëria është hapi i parë procedural për t'u ndërmarrë edhe në situatë nën masat e përkohshme. Pasi që dispozitat ligjore nuk bëjnë ndonjë dallim në mënyrë të veçantë në relacion më temën e dëgjimit, kështu që ne nuk mundë të bëjmë dallim në relacion me dëgjimin mbi masat e përkohshme. Faktet e supozuara që gjykatat tjera, si Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, pranojnë të merren me masa të tilla pa e gjykuar se pranueshmëria e parë nuk e pengon zgjidhjen e paraparë me kornizën kushtetuese të Kosovës.
15. Në rastin e tanishëm, ende nuk është marrë asnjë vendim për pranueshmëri të rasteve, dhe sipas mendimit tonë, ka qenë dashtë të ndodhë pasi që vlerat e masave të përkohshme janë ngushtë të lidhura me vlerat e rasteve të pranuar.

⁶ Neni 46 i Ligjit mbi Gjykatat

⁷ Paragrafi 37 i Rregullores së Procedurave

⁸ Neni 22 (5) i Ligjit mbi Gjykatat

⁹ Neni 22 (8) dhe (9) i Ligjit mbi Gjykatat

¹⁰ Neni 22 (6) dhe (7) i Ligjit mbi Gjykatat

3. Pranueshmëria e rastit dhe vlerat e masave të përkohshme

16. Në anën tjetër, është e ndershme të thuhet se kërkesat për masa të përkohshme të "dëmeve të pariparueshme"¹¹, ose duke iu shmangur "ndonjë rreziku apo dëmeve të pariparueshme", ose nëse një masë e tillë e përkohshme është në interes të publikut¹² sugjeroj që urgjentisht të bëhet procesimi i rastit. Por, natyra urgjente e masave të përkohshme është marrë në konsideratë nga korniza ligjore kushtuese kur është cekur se "kërkesa për masa të përkohshme do të merret parasysh nga gjykata në mënyrë të volitshme dhe do të ketë prioritet nga të gjitha rastet tjera."¹³ Pra, nevoja për një vendim ekspeditiv nuk do të thotë domosdoshmërisht dhe ekskluzivisht ndërprerja e hapave procedural. Është paraparë që kjo situatë urgjente të ketë një zgjidhje, por asgjë më tepër se sa të jetë e dobishme dhe të ketë prioritet ndaj rasteve tjera.
17. Në fund, siç është thënë se nuk ka procedurë autonome të masave të përkohshme pa pranueshmërinë e rastit, për shkak se "pala e cila i kërkon Gjykatës masa të përkohshme duhet të parashtrojë kërkesë me shkrim për një vendim mbi masa të përkohshme gjatë periudhës së procedimit të rastit që lidhet me kërkesën e bërë"¹⁴. Të themi se është e qartë në mënyrë të kristalizuar se kërkesa me shkrim për një vendim mbi masa të përkohshme zë vend në çdo kohë **gjatë periudhës së procedimit** të rastit që lidhet me kërkesën e bërë. Kjo vetëm është thënë se **inicimi i procedimit** pranë Gjykatës Kushtetuese është bërë përmes një kërkesë.
18. Shkurt, duke marrë për bazë atë çka është cekur më lartë dhe është marrë parasysh, vendimi i cili respekton të gjitha rregullat procedurale lidhur me pranueshmërinë e rastit, që është njëjtë sikur të thuhet se hapja e rrugës së procedimit të një rasti lidhur me kërkesën që vetëm është bërë, ka qenë dashtë të merret para dëgjimit publik, diskutimit dhe dënimit mbi vlerat e masave të përkohshme.

¹¹Sipas fjalëve të Kushtetutës

¹²Redaktimi i Ligjit mbi Gjykatat

¹³,Paragrafi 52 i Rregulloreve

¹⁴,Paragrafi 51 i Rregulloreve

Ne nuk mundë të themi se rasti është qartë i pranueshëm dhe s'ka nevojë për një vendim rreth pranueshmërisë së tij, por nëse është rast i tillë, të marrim një vendim të hapur.

19. Andaj, duke marrë parasysh atë çka është thënë më lartë, procedura për të kërkuar pranueshmëri të rastit dhe masa të përkohshme duhet të jetë e njëjtë si ajo që pason. Gjykatësi raportues ia ka paraqitur raportin paraprak kolegjit shqyrtues. Në ndërkohë, **ky panel**, pas vlerësimit të pranueshmërisë së rastit, duhet t'ia dërgojë të gjithë gjykatësve draft vendimin duke hedhur poshtë rastin për shkak të mungesës së pranueshmërisë ose draft vendimin që konkludon se rasti është i pranueshëm. Pra, nëse gjykatësit nuk janë anëtarë të kolegjit nuk e kundërshtojnë draft vendimin e papranueshmërisë, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese do të nënshkruante dhe lëshonte vendimin i cili e hedh poshtë kërkesën bazuar në mospranueshmëri nëse draft vendimi ka konkluduar se rasti do të mundë të jetë i pranueshëm, ose nëse një apo më tepër gjykatës jo të kolegjit nuk kanë kundërshtuar draft vendimin për të hedhur poshtë rastin, atëherë rasti është dashur t'i paraqitet Gjykatës. Ky, sipas mendimit tonë, ishte sistem i drejtë procedural për tu zbatuar nga shumica. Kjo nuk është bërë dhe ne, varësisht prej rrethanave, e mohojmë një gjë të tillë.

4. Vlerat e masave të përkohshme dhe ato të rastit

20. Për më tepër, vlerat e masave të përkohshme janë ngushtë të lidhura me ato të rastit dhe as nuk mundë të ndahen. Në fakt, disa dispozita ligjore qeverisin pranueshmërinë e rasteve dhe bëjnë kërkesa të përgjithshme për raste të regjistruara nga individët për t'u pranuar¹⁵. Disa nga këto kërkesa ndikojnë në kërkesën e masave të përkohshme. Ndër këto kërkesa janë: adresimin e çështjes ndaj gjykatës në mënyrë ligjore¹⁶; përdorimi i të gjitha mjeteve ligjore të siguruara me ligj¹⁷; regjistrimin e rastit në afatin e caktuar kohor¹⁸ dhe kështu me radhë.

¹⁵ Neni 113 (7) i Kushtetutës

¹⁶ Neni 113 (i) i Kushtetutës

¹⁷ Neni 113 (7) i Kushtetutës

¹⁸ Neni 49 i Ligjit mbi Gjykatat

21. Veç kësaj , aplikanti duhet qartazi të sqarojë se cilat të drejta dhe liri të tija janë shkelur dhe çfarë veprimi konkret i autoriteteve publike është për t'u kundërshtuar¹⁹ ; rastet duhet justifikuar, t'i bashkëngjiten informata dhe dokumente të tjera të nevojshme ndihmëse²⁰, dhe të përfshihen elemente të tjera informative²¹.
22. Më saktësisht, është vërtetuar se "kërkesa do të specifikojë arsyet për të kërkuar masa të përkohshme, pasoja të mundshme dhe masa të kërkuara"²². Në anën tjetër, masat e përkohshme mund të vendosen "nëse është e nevojshme që ato t'iu shmangen ndonjë rreziku ose dëmeve të pariparueshme, ose masë e cila është në interes të publikut"²³.
23. Të supozojmë se Tomë Krasniqi, në këtë rast, ka kërkuar masa të përkohshme ku nuk ishte i autorizuar²⁴, ose nuk i ka përdorur të gjitha mjetet e siguruar me ligj, ose kërkesa nuk është bërë në afatin e caktuar kohor për ta regjistruar rastin. A kishim mundur në këto rrethana të merremi me masa të përkohshme pa vendim për pranueshmërinë? Mendojmë se përgjigja nuk mund të jetë tjetër përveç se negative.
24. Siç është cekur më lartë, Tomë Krasniqi kundërshton ligjshmërinë dhe kushtetutshmërinë e nenit 2.1 dhe 2.2 të Udhëzimit Administrativ nr. 2003/12 i shpallur nga Përfaqësuesi i Sekretarit Gjeneral të OKB më 03.06.03, vetëm e vetëm që ai obligohet të paguajë tarifën prej 3,5 eurove nën "rrethana të vështira jetësore" që ai është duke jetuar. Ai Udhëzim Administrativ është zëvendësuar me Ligjin mbi RTK-ën dhe nuk është më në fuqi.

¹⁹ Neni 48 i Ligjit mbi Gjykatat

²⁰ Neni 22 i Ligjit mbi Gjykatat

²¹ I përmendur në paragrafin 29 i Rregullores mbi Procedurat

²² Paragrafi 51 (2) i Rregullores mbi Procedurat

²³ Neni 27 i Ligjit mbi Gjykatat

²⁴ Nga njëra anë e nenit 113 (7) të Kushtetutës

25. Meqë ra fjala, vendimi i shumicës ka potencuar se "baza ligjore dhe faktike që kontestohet nga parashtruesi i kërkesës (që ai vet e ka cekur) në ndërkohë është zëvendësuar me shpalljen e Ligjit nr. 02/L-047 mbi Radiotelevizionin e Kosovës më 20 janar 2006, (më tutje i referohet Ligjit mbi RTK-ën), derisa praktikat e vjetra ende vazhdojnë të aplikohen nga palët kundërshtarë të këtij rasti".
26. Në këtë mënyrë, të kundërshtosh kushtetutshmërinë e lëndëve juridike që nuk ekzistojnë, është tërësisht punë e kotë ose edhe e pamundur, nëse arsyeja kryesore mbështetet në "rrethanat e vështira" nën të cilat ai është duke jetuar, atëherë, ai do të mund të aplikojë për përjashtimin e tij nga kjo pagesë që është e siguar me ligj²⁵. Ai nuk e ka shfrytëzuar as këtë mjet e as ka përdorur mjetet e tjera. Përdorimi i të gjitha mjeteve juridike të siguruara me ligj është kërkesë themelore për t'u bërë palë e autorizuar. Kështu që, kërkesa për masa të përkohshme nuk duhet të pranohet, ku e njëjta vlen edhe për rastin.

5. Të drejtat dhe liritë gjoja të shkelura

27. Në kërkesën për masa të përkohshme, Tomë Krasniqi ka pretenduar se "inkasimi i 3,5 eurove ashpërsisht i shkel të drejtat qytetare dhe interesin e publikut". Se kjo thënie jo specifike është krejtësisht e pamjaftueshme për të arritur së paku te pragu i parë që saktësisht sqaron se cilat të drejta dhe liri janë shkelur, ai pretendon.
28. Ai gjithashtu ka pohuar se "ka deponuar çështjen e të drejtës civile në Gjykatën Komunale të Prishtinës që, pavarësisht nga tri kërkesa për konvokim urgjent të një sesioni juridik, ka vazhduar heshtazi pa e cekur se "çka praktikisht dhe realisht e ka penguar realizimin e të drejtës së parashtruesit të kërkesës ndaj një mjeti juridik efektiv". Ai konsideron se "Gjykata e ka shkelur nenin 32 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës -mjetet e të drejtës juridike -gjithashtu edhe nenin 6, paragrafi 1 dhe 13 i Konventës evropiane mbi të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Fundamentale dhe Protokollin e saj -neni 22, klauzola (2) e Kushtetutës së Republikës së Kosovës [zbatueshmëria direkte e dokumenteve ligjore dhe marrëveshjeve ndërkombëtare].

²⁵ Neni 20 i Ligjit mbi RTK-ën

29. Në këtë deklaratë, parashtruesi i kërkesës e përzien dhe e ngatërron të drejtën për gjykim të ndershëm²⁶ dhe të drejtën e mjeteve juridike²⁷. Të njëjtat mund të ekzistojnë së bashku, por janë të ndryshme në fushëveprimtarinë e tyre. Në fakt, neni 6 garanton te drejtën ndaj një gjykimi të ndershëm; neni 13 garanton efektivitet të nenit 6 dhe gjithashtu cakton mjetin për t'u përdorur para se rasti t'i adresohet Gjykatës Kushtetuese, mjet i cili është ndihmës por jo ai alternativ. Përndryshe, Gjykata Kushtetuese do t'i zëvendësonte të gjitha gjykatat tjera.
30. Në anën tjetër, e drejta për të kërkuar gjykim të drejtë, e paraparë me nenin 6 të Konventës Evropiane është kompetencë e përgjithshme ndaj një grupi të të drejtave tjera që lidhen me kontestin civil ; kryesisht e drejta për gjykim nga gjykata kompetente, e pavarur dhe e paanshme; e drejta për kompensim të dështimit të drejtësisë; e drejta për barazi pran ligjit dhe gjykatës; e drejta për të caktuar dhe testuar dëshmitarët; e drejta për përkthim; e drejta e avokatit; e drejta për dëgjim publik; e drejta e apelit; e drejta për dëgjim të ndershëm²⁸
31. Kjo listë, pa u dobësuar fare, prapë se prapë është e mjaftueshme dhe rëndësishme për të parë se sa vështirë është për gjykatën të konkludojë se cila e drejtë në nenin 6 të Konventës Evropiane është shkelur, mënyra dhe shkaku i shkeljes. Mund të supozohet se parashtruesi i kërkesës i referohet të drejtës për gjykim në kohë të duhur. Megjithatë, nuk varet nga gjykata për ta zëvendësuar palën duke iu përmbajtur rolit të saj "të dërgimit të lëndës gjykatës në mënyrë ligjore", kryesisht duke sqaruar se "cilat të drejta i ka paraqitur si të shkelura". Me sa duket, parashtruesi i kërkesës po e anashkalon rrugën e panjohur të shkeljes së të drejtave.

²⁶ Neni Konventës Evropiane

²⁷ Neni i 13 Konventës Evropiane

²⁸ Veç kësaj, kishim mundur t'i marrim parasysh të drejtat të tjera më tepër të lidhura me rastet kriminale, si: e drejta për supozim të pafajësisë , moslejimi për zbatim retroaktiv të ligjit penal dhe për rrezik të dyfishtë, e drejta e mosdetyrimit për të dëshmuar ose pranuar fajin, e drejta për kohë të caktuar dhe kushtet e përgatitjes së mbrojtjes, e drejta për t'u sjellë në vend pranë gjykatësit, e drejta për t'u sprovuar pa ndonjë vonesë të paarsyeshme, e drejta për ta sfiduar ligjshmërinë e arrestimit, e drejta për ta mbrojtur vet personin ose përmes avokatit, e drejta për kushtet humane të arrestimit dhe lirisë nga tortura, e drejta për ruajtjen e informative.

32. Pra, nuk është e qartë se nëse parashtruesi i kërkesës eventualisht i ka shfrytëzuar të gjitha mjetet juridike dhe cilat të drejta ai/ajo i paraqet saktësisht si të shkelura. Andaj, kërkesa për masa të përkohshme është konfuzë dhe e mangët!. Atëherë, kërkesa e tillë nuk duhet të pranohet pasi që edhe nuk duhet të ketë ndonjë rast lidhur me këtë.

a. Masat e përkohshme të kërkuara

33. Parashtruesi i kërkesës, në mënyrë më specifike, ka kërkuar "të pezullohet zbatimi i marrëveshjes ndërmjet KEK-ut dhe RTK-ës, si mjet i zbatimit të Udhëzimit Administrativ 2003/12 i datës 3 qershor 2003, mbi inkasimin e shumës prej 3,5 euro për shkak të asaj marrëveshje që, "në mënyrë të ashpër, i shkel të drejtat e qytetarëve dhe interesin publik".

34. Të përkujtojmë se kërkesa për masa të përkohshme "do të specifikojë shkaqet e kërkesës për masa të tilla sikur të mos paraqiteshin pasojat e mundshme ndaj masave të kërkuara"²⁹. Menjëherë, mund të shohim se shkaqet e dhëna "për shkak të asaj marrëveshje që, "në mënyrë të ashpër, i shkel të drejtat e qytetarëve dhe interesin publik" nuk i specifikon shkaqet e kërkesës për masa të përkohshme. Përveç kësaj, asnjë informatë nuk është dhënë mbi "rrethanat e mundshme të pa mbuluara financiarisht"³⁰.

35. Në ndërkohë, ne vërejmë se Tomë Krasniqi ka kërkuar masa të përkohshme "në përputhje me kërkesën time të 16 marsit 2009, e regjistruar në gjykatë me numër të referencës KI 11/09". Ky numër është i rastit. Gjithashtu, vërejmë se kërkesa për masa të përkohshme është një tekst prej pesë (5) faqesh . Me një kërkesë të tillë për masa të përkohshme, pa referenca të rastit, është e pamundur t'iu përmbahesh nevojave ligjore të ngritura për pranimin e kërkesës nga Gjykata.

²⁹ Paragrafi 51 (2) i Rregullores mbi Procedurat

³⁰ Ne vërejmë se Tomë Krasniqi e konsideron veten si borxhli jo ligjor për pagesën për RTK-n dhe shpreson se ai do të lirohet (përfshihet) nga një pagesë e tillë. Është e arsyeshme të konkludohet se ai nuk e paguan këtë tarifë. Kështu që në parim s'ka "pasojat e mundshme" nëse masat e përkohshme nuk jepen.

36. Duke i parë vlerat e masave të përkohshme dhe ato të rastit veç e veç në kontekst të tillë 'procedural që është miratuar me vendim të shumicës, mundë të krijojë dilema për gjykatën. Në fakt, shumica duhet të zgjedhë: që kërkesa për masa të përkohshme nuk i plotëson nevojat dhe e njëjta duhet të hidhet poshtë, duke mos përfillur aspak lidhjet e bëra nga vet parashtruesi i kërkesës ndërmjet rastit dhe kërkesës; ose kur vendoset mbi vlerat e kërkesës, vendimi i shumicës duhet marrë parasysh ato së bashku me rastin dhe në mënyrë konsekuente duhet marrë vendim mbi pranueshmërinë e rastit si mënyrë e vetme procedurale për të shqyrtuar rastin. Se si ne mendojmë, kjo ka qenë dashur të bëhet së paku për hir të të qenit transparent dhe i paanshëm.
37. Shumica ka vendosur për rastin e dytë. Në fakt, ajo ka filluar për herë të parë së aplikuari vendimin e saj duke konsideruar se, meqenëse kërkesa nuk i përket vetëm interesit personal por edhe atij të publikut "mendohet se për këtë arsye është e favorshme të plotësohet ajo për masa të përkohshme". Në ndërkohë, nuk është e qartë nëse vendimi i shumicës është bazuar në interesin publik ose edhe në atë personal që do të thotë se ne nuk e dimë a është vendimi *ex-officio* ose me kërkesë të palës.

II. Vlerat e vendimit mbi masat e përkohshme

38. Vendimi i shumicës në hyrje thotë se lënda është "kërkesa e 2 shtatorit 2009 rreth imponimit të masave të përkohshme për rastin KI 11/09, i deponuar nga Z. Tomë Krasniqi kundër RTK-ës et AI.
39. "Gjykata Kushtetuese *ex-officio* apo me rastin e ndonjë pale përkohësisht mund të vendos me masat e përkohshme në një rast kur i nënshtrohet procedimit, nëse masat e tilla nevojiten për t'iu shmangur rrezikut ose dëmeve të pariparueshme, ose nëse një masë e tillë e përkohshme është në interes të publikut"³¹. Ne duhet të kuptojmë se "individët" si "palë" (...) e autorizuar duhet t'iu referohen shkeljeve dhe kërkojnë masa të përkohshme"³². Në këtë rast Tomë Krasniqi është si palë.

³¹ Neni 27 1 Ligjit mbi Gjykatat

³² Neni 11 3 (7) i Kushtetutës

40. Vendimi i shumicës e ka konsideruar se "kjo kërkesë individuale nuk e prek vetëm interesin personal të parashtruesit të kërkesës por edhe të publikut, (...) pasi që shuma prej 3,5 euro e paraparë në disa dispozita të nenit 20.1 të ligjit mbi RTK-ën është pjesë e shqetësimeve të publikut gjithashtu". Për më tepër, vendimi i shumicës e ka menduar se "Tomë Krasniqi në aplikacionin e tij kërkon kontroll *in abstracto* të kushtetutshmërisë së disa dispozitave që rregullojnë punën e RTK-s, pasi që "kërkesa (...) ka të bëjë me ligjet e vendit dhe me praktikat administrative bazuar në to". Veç kësaj, vendimi i shumicës e ka konsideruar se "këtu nuk kemi të bëjmë me një *actio popularis*, sepse këtu duhet të merremi jo vetëm me interesin individual por edhe me atë publik.
41. Më poshtë, janë disa pyetje si rezultat i vlerësimeve të vendimit të shumicës:
- (1) A ka ndonjë lidhje në mes "*ex-officio*" dhe "interesit publik" në një anë dhe në mes "të rastit të një pale" dhe "shmangies së rrezikut ose dëmeve të pariparueshme" në anën tjetër?
- (2) A është individ i palë e autorizuar për të përfaqësuar dhe mbrojtur interesat e të tjerëve ose edhe të tij?
- (3) A është individ i palë e autorizuar "për të kërkuar kontroll *in abstracto* të kushtetutshmërisë së disa dispozitave që rregullojnë punën e RTK-s"?

1. Ekziston apo jo ndonjë raport në mes

42. Me sa duket nuk ka ngjashmëri ndërmjet elementeve të përmendura marrëdhëniesh. Në një mënyrë ato janë të këmbyeshme në kuadër të limiteve të caktuara. Në fakt masat ë përkohshme mund të vendosin *ex officio* me kërkesën e një pale ose pa kërkesë, nëse masat e tilla të përkohshme janë në interes të publikut duke e pranuar rastin si ekzistent. Por, nëse të njëjtat masa nevojiten për shmangien nga rreziku ose nga dëmet e pariparueshme të interesit privat, gjykata mund të vendosë masa të përkohshme vetëm me kërkesën e palës së interesuar. Ky komentim është në përputhje me parimet e përgjithshme të dispozitivit.
43. Në këtë mënyrë, kërkesa e një pale mund të luajë rolin e përkujtuesit për gjykatën që të aplikojë masat ë përkohshme *ex officio* në interesin publik. I vetmi kusht është se ekzistojnë rrethana të caktuara për t'iu "shmangur rrezikut apo dëmeve të pariparueshme" ose të kujdesen për interesat publike. Por, *ex officio* nuk nënkupton që gjykata të iniciojë vet pa pasur

ndonjë rast, pasi që ajo vepron me iniciativën e ndonjë pale të autorizuar kështu që nuk mund t'i hyjë çështjes si e vetme dhe të hulumtojë nëse masat ë përkohshme janë të nevojshme ose jo dhe të gjejë vendin ku ato nevojiten. Kjo do të thotë se gjykatësit i nevojitet një bazë faktike me anë të së cilës mund të konkludohet se masat e përkohshme janë të nevojshme në rrethana të caktuara.

44. Nocioni i interesit publik është më i gjerë se ai privat dhe me këtë kërkohet më tepër balancim dhe diskrecion. Për më tepër, të kujdesesh për interesin publik është kompetencë dhe detyrë e të gjitha organeve të ndryshme shtetërore. Kështu që gjithmonë ekziston rreziku i ndërhyrjes ose konflikte me veprimet ligjore ose vendimet nga organet tjera kur vlerësohet se veprimet e tilla ose vendimet janë marrë "në interes të publikut". Për shembull, a është miratuar ligji mbi RTK-ën në mënyrë legjitime nga Kuvendi i Republikës në interes të publikut? Nëse përgjigja është negative, atëherë gjykata duhet të demonstrojë dhe deklarojë se ky ligj është miratuar kundër interesave të publikut në kuptim të interpretimit jo të drejtë të Kushtetutës ose në shkeljen e saj.
45. "Gjykata Kushtetuese është organ i pavarur për mbrojtjen e kushtetutshmërisë dhe autoriteti përfundimtar për interpretimin e kushtetutës"³³ dhe përputhshmërinë e ligjeve me Kushtetutën"³⁴". Pra, mbrojtja e kushtetutshmërisë dhe përputhshmërisë me ligjet e saj është i vetmi material i juridiksionit të Gjykatës.
46. Andaj, Gjykata nuk e posedon të drejtën e interesit publik për të pezulluar një veprim të një autoriteti pa e demonstruar se me një veprim të tillë bëhet interpretim jo i duhur i Kushtetutës dhe shkeljes së saj dhe të themi se për atë shkak është kundër "interesit publik" duke pretenduar se Kushtetuta përfaqëson interesat e publikut në nivelin më të lartë juridik. Dhe kur kjo të bëhet, atëherë gjykata mund t'i bëjë thirrje publikut ta pezullojë një veprim të tillë. Vendimi i shumicës, siç është cituar më lartë, ka menduar se "shuma prej 3,5 euro e cekur në disa dispozita të nenit 20.1 të ligjit mbi RTK-ën është gjithashtu shqetësim publik". Pra, interesi publik nuk është njëjtë si shqetësimi publik. Duhet përkujtuar se nocioni i interesit publik i përket domenit të diskrecionit juridik; por jo atij arbitrar.

³³ Neni 4 (6) i Kushtetutës

³⁴ Neni 112 i Kushtetutës

Me fjalën diskrecion juridik nënkuptojmë fuqinë e gjykatës për të ndërmarrë hapa ose dhënë mjete ose jo, siç mendohet t'i përshtatet rrethanave, par gjithmonë në kuadër të limiteve juridike. Dhe nëse dalim jashtë këtyre limiteve, ne rrezikojmë të hyjmë në arbitrim.

47. Duke i prirë të mëparshmes, është vështirë për ne ta kuptojmë vlerësimin e vendimit të shumicës se "metodologjia e përdorur për financimin e transmetimit publik në Kosovë duhet të jetë një nga praktikat më të mira të Evropës me standardet e saja ligjore". Miratimi i metodologjisë më të përdorur për financimin e transmetimit publik në Kosovë varet nga Kuvendi i vet Republikës i cili e ushtron fuqinë dhe nga Qeveria e cila është përgjegjëse për zbatimin e ligjeve dhe politikave shtetërore duke iu nënshtruar kontrollit parlamentar. Përfundimisht, varet prej gjykatave për të ushtruar fuqinë ligjore duke u bazuar në kushtetutë dhe ligj . Gjykata Kushtetuese ushtron fuqinë ndihmëse juridike gjate mbrojtjes së kushtetutshmërisë dhe përputhshmërisë së ligjeve më kushtetutën në pajtim me vet kushtetutën, ligjin mbi gjykatat, rregullat procedurale dhe mjetet tjera aplikative ligjore ndihmëse.
48. Me tërë respektin që e kemi, vendimi i shumicës nuk merr parasysh parimet kushtetuese të cekura më lartë kur imponohen masat e përkohshme për zbatimin e mëtutjeshëm të dispozitave ligjore 20.1 të ligjit mbi RTK-ën, derisa vendimi mbi vlerat rekomandon Kuvendin të shqyrtojë sërish natyrën dhe shumën tarifore siç është paraparë në ato dispozita ligjore dhe praktikat e bazuara në to. Ne nuk pajtohemi me vendimin e asaj pike dhe për këtë e shprehim mospajtimin tonë.

2. Nëse individi është palë e autorizuar me Kushtetutë që përfaqëson dhe mbron interesat e të tjerëve dhe të atij ose jo

49. Vendimi i shumicës ka vërejtur se "kërkesa për masa të përkohshme e parashtruar nga Tomë Krasniqi nuk është një *actio popularis*, siç mund të duket në radhë të parë". Shihet më tut je se nuk është një *actio popularis* "për shkak të faktit se ekziston një vendim gjyqësor i fuqishëm dhe precedental i Gjykatës Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut, i cili bazohet në nenin 53 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës që duhet shërbejë si bazë e fortë gjatë kohës së interpretimit të të gjitha vendimeve tona".
50. Për momentin, ta përkujtojmë se *actio popularis* është një modalitet i ankesave individuale që mundësojnë çdo person i cili kërkon mbrojtje të

interesave publike dhe rendit kushtetues t'i paraqes shkeljet organit kushtetues të së drejtës pa kërkuar prova personale apo individuale dhe shterjen e të gjitha mjeteve juridike.

51. Me prezantimin e këtij nocioni, duket se vendimi i shumicës i dyfishon shprehjet me përdorimin dykuptimësh të fjalës *actio popularis*. Në fakt, ky vendim i ngatërron dy lëmi të ndryshme të zbatimit të vendimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut: njëra është e pavarur kurse tjetra procedurale. Faktikisht, është e vërtetë se neni 53 i kushtetutës përcakton se "të drejtat e njeriut dhe liritë fundamentale të garantuara me këtë kushtetutë që do të interpretojë në mënyrë konsekuente vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Kështu që, "të drejtat e njeriut dhe liritë fundamentale" janë substancë përbërëse e Ligjit për të Drejtat e Njeriut. Përkundrazi, *actio popularis* i përket domenit procedural. Vendimi i shumicës e pranon se *actio popularis* është aspekt procedural kur thuhet se "vendimi i fuqishëm gjyqësor i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut thotë se pala mund të kërkojë një masë të tillë dhe ajo mund ri jepet nëse sjell prova *prima facie* të një praktike të tillë dhe ato të të qenit viktimë". A është nocioni që se paku "pala mund të pyes për masa të tilla" dhe që "prova *prima facie*" të jetë më tepër koncept procedural? Mendojmë se ato janë shembujt më të mirë të koncepteve procedurale. Sjellja e provave *prima facie* pikërisht do të thotë iniciativa e një pale në rast se ka prova të mjaftueshme të evidentohen në mungesë të atyre adekuate që nuk mund të kundërshtohen. Ky është një dallim i provave të publikut dhe fakteve të njohura.
52. Në fund, vendimi i shumicës është i paqëndrueshëm: nga njëra anë thuhet se nën sistemin juridik kushtetues të vendit "kërkesa për masa të përkohshme nga Tomë Krasniqi nuk është një *actio popularis*; kurse në anën tjetër "nuk është që (ne vetëm e kemi pranuar si të vërtetë një *actio popularis*) për shkak të faktit se nuk ka një vendim të plotë të fuqishëm gjyqësor të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut". Por, ende nuk është informative se një vendim i plotë i fuqishëm gjyqësor është i karakterit të pavarur. Në fund kur vendimi i shumicës arsyetohet, ne presim që përmes mekanizmit ndihmës të nenit 53 të kushtetutës do të ishte pranuar se kërkesa për masa të përkohshme nga Tomë Krasniqi është një *actio popularis*. Por, jemi të befasisur me rezultatin se "këtu nuk kemi të bëjmë me *actio popularis*" edhe pse kemi të bëjmë "jo vetëm me interesat individuale por edhe me ato publike gjithashtu". A është e

ndershme të thuhet se konkludimi i shumicës ishte që "ne nuk kemi të bëjmë me *actio popularis*, edhe pse kemi të bëjmë "jo vetëm me interesat individuale por edhe me ato publike gjithashtu", ne duhet të veprojmë ashtu siç *actio popularis* ishte. Nuk besojmë se shumica e ka arsyetuar në atë mënyrë edhe pse e njëjta mënyrë do të çonte drejt kontrollit *in abstracto* të kërkuar të kushtetutshmërisë.

3. Nëse individi është apo jo palë e autorizuar "për të kërkuar kontroll *in abstracto* të kushtetutshmërisë së disa dispozitave që rregullojnë punën e RTK-s"?

53. Vendimi i shumicës edhe më tej ka konsideruar se "Tomë Krasniqi në kërkesën e tij kërkon kontroll *in abstracto* të kushtetutshmërisë së disa dispozitave që rregullojnë punën e RTK-s. Por, ky vlerësim rreth kërkesës për kontroll *in abstracto* të kushtetutshmërisë është i mundur nëse *actio popularis* është pranuar. Në një mënyrë, Tomë Krasniqi nuk është palë e autorizuar për të kërkuar kontroll *actio popularis* të kushtetutshmërisë së ndonjë akti ligjor. Në Kosovë, e drejta kushtetuese, ankesat individuale nuk nënkuptojnë *actio popularis*. Në anën tjetër nuk është e mundur të importohen ankesat individuale nga një sistem tjetër ligjor, e kryesisht nga vendet evropiane pasi që fjala nocion nuk përfshinë konceptin uniform. Ankesa individuale mund të nënkuptojë realitete shumë të ndryshme.
54. Në kuptimin më të gjerë, ankesa individuale është kërkesë ndaj të drejtës kushtetuese lidhur me kushtetutshmërinë e akteve ligjore (më së shumti aktet normative) të aplikueshme ndaj këtij individi ose lidhur me veprimet (ose akte të dështuara) e institucioneve shtetërore ose zyrtarëve të sajë që, sipas mendimit të parashtruesit të kërkesës, të drejtat e tyre kushtetuese dhe liritë janë shkelur dhe kufizuar, gjithashtu. Kjo masë procedurale ka për qëllim të mbrojtë liritë dhe të drejtat e njeriut. Dosido, nuk ka model të unifikuar. Gati në të gjitha shtet evropiane³⁵ në të cilat gjykatat kushtetuese janë themeluar me kohë, ankesat individuale ende ekzistojnë.

³⁵ Për një qasje krahasuese të vendeve tjera evropiane, për së afërmi e kemi ndjekur Z. Kestutis Lapinskas, "Perspektiva e ankesave kushtetuese individuale ne Lituani" në konferenca e quajtur "E drejta kushtetuese dhe sundimi i ligjit në Kaukazin Jugor" Komisioni Evropian për Demokraci Njëpërmjet Ligjit

55. Pavarësisht nga dallimet, ankesat individuale janë të ngjashme në vende të ndryshme, kështu që mund të gjejmë elemente të përbashkëta ku individët janë palë të autorizuar për t'iu drejtuar gjykatës; dhe si objekt i rastit është shkelja e të drejtës kushtetuese ose liritë; ekzistimi i një gjykate të specializuar që i merr parasysh ankesat e tilla; procedura të posaçme për vlerësimin e ankesave në gjykatë. Mirëpo, përmbajtja konkrete e secilit element, posaçërisht detajet e tyre, mund të jenë të ndryshme në shtetet tjera.
56. Në vendet ku merren masa ndaj ankesave individuale që është parashikuar me ligj, janë masa të caktuar ligjore që parandalojnë gjykatat kushtetuese nga vërshimi i madh i ankesave. Për shembull, ankesat e tilla më se shumti lejohen vetëm pas shfrytëzimit të të gjitha mjeteve juridike. Veç kësaj, e njëjta ankesë duhet të regjistrohet gjatë një afati të caktuar kohor pasi të miratohet një vendim, akt ose ligj i caktuar. Ekzistojnë gjithashtu kushte të tjera shtesë, siç janë; që ankesa në fjalë duhet të përpilohet nga avokati ose juristi, ose taksave administrative, të një madhësie të caktuar, duhen paguar.
57. Ankesat individuale lidhur me shkeljen e të drejtave kushtetuese janë edhe më tej të ndara në shtetet evropiane sipas nënshtetasve të cilët mund t'ia adresojnë drejtësisë së kushtetutës aktet ligjore të hedhura poshtë, gjithashtu edhe shtrirjen e të drejtave që janë të ruajtura dhe mbrojtura nga ankesat individuale. Duke marrë parasysh aspektet e përbashkëta dhe disa veçori të ankesës individuale, mund të grupohen në kategori që pasojnë në vijim
- i) Juridikisht kërkuesve iu lejohe t'i mbrojnë të drejtat jo vetëm të tyre por edhe të personave tjerë, dhe gjithashtu edhe ato publike. Ankesa e tillë quhet *actio popularis* (ankesa e veprimeve publike ose ankesa lidhur me mbrojtjen e interesit publik) që vetëm është përkufizuar më lartë;
 - ii) Kërkuesi mund të sfidojë aktet juridike të miratuara nga institucionet shtetërore por edhe ato të dështuara. Kjo ankesë i takon një *veprimtarie të gjerë* (ose ankesës klasike). Është përgatitur për të mbrojtur pa përjashtim të gjitha të drejtat dhe liritë e njeriut që janë të mbrojtura me kushtetutë por edhe me traktatet ndërkombëtare;
 - iii) Kërkuesi mund të depozitojë një ankesë që lidhet vetëm me aktet normative në bazë të cilës vendimi i natyrës individuale është miratuar (Letonia, Polonia dhe Rusia). Kjo ankesë i përket një *fushe të kufizuar*. I

përfshinë vetëm vendimet e natyrës individuale (Çekia, Sllovakia dhe Slovenia). Nuk përfshinë të gjitha të drejtat që janë të renditura në kushtetutë (Belgjika, Spanja) por jo të gjitha aktet juridike të aprovuara nga institucionet shtetërore.

58. Në perspektivën krahasuese dhe duke marrë parasysh nenin 113 7 të kushtetutës dhe nenin 46 deri në 49 të ligjit mbi gjykatat, e shohim qartë se sistemi juridik kushtetues nuk e ka aprovuar *action popularis-in*. Kështu që, juridikisht nuk pranohet se, siç është cekur në vendimin e shumicës, "Z. Tomë Krasniqi në kërkesën e tij kërkon kontroll *in abstracto* të kushtetutshmërisë së disa dispozitave që rregullojnë punën e RTK-ës. Nëse kontrolli *in abstracto* i kushtetutshmërisë në të vërtetë është kërkuar, atëherë kërkesa e tillë ka qenë dashtë të refuzohet.
59. Përsëri, duam të theksojmë se mospërputhja e mendimeve tona është ngritur si rezultat i mospajtimit tonë duke pas për bazë konkludimet juridike të besueshme të shumicës. Pasi që japim konkludime të ndryshme juridike lidhur me interpretimin dhe aplikimin e sistemit juridik kushtetues dhe pasi që konkludojmë se interpretimi dhe aplikimi që ne e miratojmë kërkon vendim të ndryshëm, nuk mund të pajtohemi më vendimin e shumicës. Andaj, ne mendojmë në mënyrë aktive dhe thjeshtë se shumica ka gabuar në imponimin e ma save të përkohshme të cekura më lartë, për të cilat, me keqardhje, nuk pajtohemi.

Prishtinë, 19 tetor 2009

Gjyqtari Almiro Rodrigues

Lënda KI 11/09, Tomë Krasniqi vs RTK-në dhe KEK-u

Mendim mospajtues për masën e përkohshme

Gjyqtarja Dr. Gjyljeta Mushkolaj

1. Me gjithë respektin, shpreh mospajtim me Vendimin e shumicës për masën e përkohshme, prandaj i bashkohem mendimit mospajtues të gjyqtarit Almiro Rodrigues. Për më tepër, unë besoj se Vendimi i shumicës për të ndaluar zbatimin e mëtejme të Nenit 20.1 të Ligjit për RTK duke e konsideruar atë si shkelje të interesit publik, e injoron në tërësi garancinë kushtetuese të lirisë së shprehjes¹ dhe të lirisë e të pluralizmit të medieve.

I

2. Garantimi i lirisë së shprehjes i referohet me forcë të veçantë medieve, përfshirë shërbimet publike transmetuese. Për të qenë në gjendje që të shërbejnë si përhapës të lajmeve dhe si analistë të çështjeve publike, shërbimet publike transmetuese duhet të kenë shkallën më të lartë të mundshme të lirisë, brenda strukturës së të drejtës kushtetuese për lirinë e shprehjes.
3. Një ndër arsytet qenësore që mbështesin shërbimet publike transmetuese është se ato i japin ndihmesë të rëndësishme pluralizmit. Një numër instrumentesh ndërkombëtare e theksojnë rëndësinë e shërbimeve publike transmetuese dhe kontributin e tyre për nxitje të diversitetit dhe të pluralizmit.
4. Natyrisht, pavarësia e shërbimeve publike transmetuese është pandashëm e lidhur me financimin adekuat të tyre. Ky fakt gjithashtu është theksuar qartë në shumë standarde të publikuara ndërkombëtare.

¹ Neni 40 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës

² Neni 42 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës

5. Për shembull, Rezoluta e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës për të ardhmen e Shërbimit Publik Transmetues, fuqishëm e thekson rëndësinë qendrore të pavarësisë financiare të shërbimit publik transmetues, siç e bëjnë edhe shumë dokumente të tjera të nxjerra nga ky organ viteve të fundit³. Financimi i shërbimeve publike transmetuese jo vetëm që duhet të jetë në pajtueshmëri me detyrimet e tyre, por gjithashtu duhet t'i mbrojtë ato nga rritjet ose zvogëlimet arbitrare të financimeve për teket e kujtdo qoftë që kontrollon paranë.
6. Dispozitat e neneve 17-19 të Rekomandimit nr. R (96) 10 të Komisionit të Ministrave të Këshillit të Evropës për Garanci të Pavarësisë së Shërbimit Publik Transmetues, vënë në dukje se investimi për shërbimet publike transmetuese duhet të jetë i përshtatshëm për detyrat e tyre, i sigurt dhe transparent. Marrëveshjet financiare nuk duhen t'i vënë transmetuesit publik në 'pozitë të përshtatshme për ndërhyrje, për shembull në pavarësinë redaktuese ose në autonominë institucionale⁴.
7. Nevoja për qëndrueshmëri dhe siguri të financimit është theksuar në dokumentin e Unionit Evropian të Transmetuesve të botuar në vitin 2009:
"Që një financim i tillë të jetë i qëndrueshëm dhe i sigurt, kërkon një bazë të qartë ligjore (të veçantë nga ligji që miraton buxhetin e shtetit), e cila parasheh nivelin e investimit për një periudhë të përshtatshme kohore. Varësia nga vendimet vjetore (të buxhetit të shtetit) ose nga masat ad hoc, mund të krijojë klimë pasigurie dhe mund ta minojë mundësinë e transmetuesit publik për të planifikuar dhe për të investuar.⁵
8. Rekomandimi 1878 (2009) i Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës për financimin e transmetuesit të shërbimeve publike thotë se "financimi i mediave publike mund të sigurohet përmes pagesës lineare të transmetimit, taksës, subvencioneve shtetërore, parapagimit, të ardhurave nga reklamat dhe sponsorizimet, pagesës së specializuar

³ Rez. 428 e vitit 1970 dhe Rez. 748 e vitit 1975 e Asamblesë Parlamentare, KE, shih gjithashtu Rez. 2 (Konf. e pestë, 1997) e Konferencës Ministrore, KE.

⁴ Rek. R (96)10, Këshilli i Evropës, shënimi 26 si më sipër, Nenet. 17-19

⁵ Financimi i transmetuesit të shërbimit publik (9 nëntor 2000). Marrë me 1 qershor 2005, nga http://www.ebu.ch/CMSimages/en/leg_p_funding_psb_tcm6-4443.pdf

paguaj për të shikuar ose në bazë të shërbimit të kërkuar, shitjes së produkteve të përafërta siç janë librat, videot, ose filmat, dhe shfrytëzimit të arkivave të tyre audio-vizuale. Në këtë drejtim, mediumi i shërbimit publik mund të kenë financim të përzier, të ngjashëm me atë të institucioneve të tjera publike si orkestrat, teatrot ose muzetë."

9. "Article 19", një organizatë ndërkombëtare e shoqërisë civile me ekspertizë për standardet e shërbimeve publike transmetuese, vë në dukje se organizatat e shërbimeve publike të transmetimit luajnë rol të veçantë dhe qenësor në përmbushjen e *interesit publik* dhe sigurojnë rrjedhë të lirë të informacioneve dhe ideve, ndaj duhen nxitur qeveritë dhe përfaqësuesit e tjerë publik që të bëjnë një përkushtim solid për të financuar këtë pasuri publike me rëndësi të veçantë⁶
10. Prandaj, neni 20.1 i Ligjit për RTK-në është plotësisht në pajtueshmëri me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me standardet më të mira ndërkombëtare e evropiane. E drejta e ligjvënësit për të vendosur parapagimin për transmetuesin publik duke siguruar një mekanizëm i cili në mënyrë efektive lejon heqjen e rasteve sociale nga pagesa e parapagimit, siç siguron Ligji për RTK-në, është plotësisht në pajtueshmëri me *interestin publik*.
11. Ndalimi i zbatimit të mëtejshëm të dispozitës së nenit 20.1 të Ligjit për RTK do t'a privojë RTK-në nga fondet e domosdoshme, duke ndikuar drejtpërdrejtë në shtrirjen dhe cilësinë e programeve të tij dhe vazhdimësinë e tij si shërbim i pavarur publik transmetues. Prandaj, nuk është në interes publik, që të vihet masa e përkohshme, respektivisht të ndalohej zbatimi i mëtejshëm i nenit 20.1.

⁶ Toby Mendel, Public Service Broadcasting: A Comparative Legal Survey, at www.article19.org

12. Vendimi i Shumicës me të cilin i rekomandohet Kuvendit që të rishikojë natyrën e nenit 20.1 të Ligjit për RTK, dhe praktikën e bazuar në ato dispozita deri më 1 dhjetor 2009, keqkupton natyrën e RTK-së si institucion i pavarur. Meqë Ligji për RTK e njeh këtë tipar të rëndësishëm të RTK-së, ai nuk e autorizon Kuvendin të marrë si i vetëm vendim për vlerën e parapagimit të transmetuesit publik. Ligji përcakton që Kuvendi mund të merr një vendim të tillë vetëm sipas propozimit të bërë nga Bordi i RTK-së, pas konsultimeve me Komisionin e Pavarur për Media⁷. Duke pasur parasysh këtë, afati i përcaktuar me Vendimin e shumicës është jo realist.
13. Amandamentimi i ligjit është proces demokratik që kërkon konsultimin e publikut dhe angazhimin e ekspertëve. Ndryshimi i pagesës së parapagimit është çështje me interes publik, dhe sipas meje, gjykata nuk ka të drejtë të ndërhyjë duke përjashtuar publikun nga procesi i vendimmarrjes.

Vendimi i Shumicës është shumë kontradiktor, dhe nuk jep asnjë justifikim se neni 20.1 i Ligjit për RTK shkel interesin publik.

Me gjithë respektin, për arsyet e dhëna në mospajtimin e gjyqtarit Almiro Rodrigues dhe për arsyet që unë i kam dhënë, nuk pajtohem me Vendimin e shumicës. Nuk gjej asgjë në gjuhën ose frymën e Kushtetutës për të mbështetur Vendimin e Shumicës.

Gjyqtarja

Dr. Gjyljeta Mushkolaj

⁷Neni 20.2 i Ligjit për RTK, Rregullorja Nr. 2006/14, 11 prill 2006

Mendim konkurrues

Gjyqtar Almiro Rodrigues

Aktgjykimi në rastin nr. KO 01/09

E pranoj pjesën operative të Aktgjykimit. Megjithatë, me respekt shpreh mospajtimin tim me paragrafin 54 për arsyet në vijim.

1. Kushtetuta e Kosovës është në pjesën e saj më të madhe e ndërtuar në bazat e *'Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës'* (Korniza Ahtisaari) si dhe qëndron mbi themelet e një kornize të gjerë legislative që synon mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve jo-shumicë.
2. Neni 57.1 i Kushtetutës i përkufizon komunitetet si "banorë që i përkasin një grupi të njëjtë kombëtar ose etnik, gjuhësor ose fetar, tradicionalisht të pranishëm në territorin e Republikës së Kosovës".
3. Megjithatë, ligji për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Anëtarëve të tyre jep një përkufizim më të ngushtë për komunitete: Për qëllimet e këtij ligji, komunitetet përkufizohen si grupe kombëtare, etnike, kulturore, gjuhësore apo fetare tradicionalisht të pranishme në Republikën e Kosovës të cilat nuk janë shumicë. Ky përkufizim vjen vetëm për grupet që janë pakicë në numër. Komunitetet jo-shumicë përmenden përgjithësisht si "komunitete".

¹Neni 2.4 i Ligjit mbi Përdorimin e Gjuhëve Zyrtare parasheh që:

"Në ato komuna ku jeton një bashkësi, gjuha amtare e së cilës nuk është njëra nga gjuhët zyrtare në Kosovë përfaqëson më shumë se tre (3) për qind të popullatës së përgjithshme të komunës, gjuha e asaj bashkësie do të ketë statusin e gjuhës në përdorim zyrtar në atë komunë dhe do të jetë në përdorim të barabartë në pajtim me dispozitat e përcaktuara në nenin 8 të këtij ligji. Përveç kësaj, një bashkësi, gjuha e së cilës me traditë është folur në një komunë do të ketë statusin e gjuhës në përdorim zyrtar në atë komunë."

4. Në anën tjetër, Kapitulli i parë i Kushtetutës përcakton dispozitat themelore të Shtetit të Kosovës. Disa nga këto dispozita kanë të bëjnë me komunitetet. Për shembull, Kushtetuta thotë që Kosova është shtet shumë-etnik dhe sekular, si dhe që gjuha shqipe dhe ajo serbe janë gjuhët zyrtare të Kosovës. derisa gjuha boshnjake, rome dhe turke janë gjuhë zyrtare në nivel komunal.
5. Në fakt, neni 62.1 i Kushtetutës përcakton që "në komunat në të cilat së paku dhjetë për qind (10%) të banorëve u përkasin komuniteteve, të cilat në ato komuna nuk janë shumicë, posti i zëvendëskryetarit për komunitete të kuvendit të komunës do të rezervohet për një përfaqësues nga radhët e këtyre komuniteteve". Kështu, në këto komuna, komunitetet do të përfaqësohen nga Zëvendës Kryesuesi i Kuvendit të Komunës për Komunitete, i cili do të jetë kontakt personi për shqyrtimin e brengave dhe interesave të komuniteteve jo-shumicë.
6. Në këtë rast, parashtruesi në kapacitetin e Zëvendës Kryesuesit të Kuvendit të Komunës për Komunitete, si dhe në pajtim me nenin 62.4 të Kushtetutës, i ka parashtruar çështjen drejtpërdrejt Gjykatës, pa pasur nevojë të shterojë gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Megjithatë, Zëvendës Kryesuesi i Kuvendit të Komunës për Komunitete nuk vepron personalisht; ai duhet të veprojë në emër të Komuniteteve si dhe të jetë garantues i procesit të pjesëmarrjes së komuniteteve, përmes mekanizmave të vendosur me ligj.
7. Përveç garantimit të përfaqësimit të komuniteteve në institucione publike, Kushtetuta mbron edhe të drejtat e pakicave në procesin legjislativ. Për më tepër, në pajtim me nenin 81 të Kushtetutës, disa fusha të legjislacionit, si *Ligji për përdorimin e gjuhëve, Ligji për Zgjedhjet Lokale, si dhe Ligjet për përdorimin e simboleve. duke përfshirë simbolet e komuniteteve, si dhe për festat publike,* konsiderohen të jenë me interes jetik.
8. Një tjetër mënyrë në të cilën Kushtetuta mbron të drejtat dhe interesat e komuniteteve është përmes sistemit të decentralizimit, në bazë të të cilit komunitetet fitojnë autonomi qenësore në nivelin lokal, sidomos në zonat ku komunitetet përbëjnë popullsi shumicë. Këtu, *Ligji mbi Vetë-Qeverisjen Lokale* themelon bazën ligjore për vetë-qeverisje të qëndrueshme lokale në nivelin komunal².

Neni 55 i atij Ligji rregullon detyrat dhe kompetencat e Zëvendës Kryesuesit të Kuvendit të Komunës. Sipas këtij neni, Zëvendës Kryesuesi i Kuvendit të Komunës "shërben si pikë qendrore zyrtare për adresimin e brengave dhe interesave të komuniteteve joshumicë". Kjo do të thotë që mendimi personal i Zëvendës Kryesuesit të Kuvendit të Komunës nuk është autoritativ në lidhje me respektimin e të drejtave të komuniteteve të mbrojtura me Kushtetutë. Në vend të kësaj, Zëvendës Kryesuesi i Kuvendit të Komunës për Komunitete është përgjegjës "për shqyrtimin e ankesave të komuniteteve apo pjesëtarëve të tyre, në mënyrë që aktet apo vendimet e kuvendit të komunës të mos i shkelin të drejtat e garantuara kushtetuese të tyre"³.

9. Në rast, Zëvendës Kryesuesi i Kuvendit të Komunës për Komunitete ka shprehur mendimin e tij kur në dëgjimin publik, e jo në parashtresën e tij, ka deklaruar që fjalët "Komuna", "Opstina" dhe "Belediye" duhen shkruar në emblemën e Komunës pa vitin "1878". Kështu, ai nuk ishte duke përfaqësuar Komunitetet, apo duke shprehur një mendim të nxjerrë përmes një procesi me pjesëmarrjen e komuniteteve.

Lidhur me këtë çështje, komunat do të miratojnë rregullore të hollësishme brenda 6 muajve pas hyrjes së këtij ligji në fuqi. Në pajtim me nenin 35 të këtij ligji".

Neni 35 ka rëndësi të veçantë, pasi obligon komunat "që në aktet e tyre të miratojnë rregullore të hollësishme për përdorimin e gjuhëve. në pajtueshmëri me ligjin për përdorimin e gjuhëve zyrtare.

Përveç këtij, neni 9.2 përcakton:

"Shenjat zyrtare që shënojnë apo përfshijnë emrat e komunave, fshatrave, rrugëve, rrugicave dhe të vendeve të tjera publike,

paraqiten në gjuhët zyrtare dhe në gjuhët e komuniteteve, gjuha e të cilave ka statusin e gjuhës zyrtare në komunë, në pajtueshmëri me nenin 2.3".

² Ligji Nr. 03/L-040 MSI VETËQEVERISJEN LOKALE i obligon komunat të krijojnë kushte të përshtatshme që u mundësojnë të gjithë komuniteteve për ti shprehur, ruajtur, zhvilluar identitetet e tyre etnike kulturore, fetare dhe gjuhësore (neni 4.3 i Ligjit).

³Shih nenin 62.3 të Kushtetutës dhe nenin 55.2 të Ligjit mbi Vetë-Qeverisjen Lokale.

Gjithashtu, neni 62.4 i Kushtetutës dhe neni 55.3 i Ligjit obligojn Zëvendës Kryesuesin e Kuvendit të komunës t'i referojë rastet e tilla tek Kuvendi i Komunës për rishqyrtim të aktit apo të vendimit.

10. Në fakt, propozimi i parashtruar nga Zëvendës Kryesuesi i Kuvendit të Komunës për Komunitete nuk mund t'i nënshtrohet shqyrtimit të Gjykatës, pasi i njëjti as nuk është diskutuar, e as miratuar nga Komiteti për Komunitete i Kuvendit të Komunës si kontribut i veçantë për rastin . Kështu, Gjykata duhet të përmbahet nga shprehja e mendimit mbi arsyeshmërinë e propozimit. Për më shumë, Zëvendës Kryesuesi i Kuvendit të Komunës për Komunitete nuk ka paraqitur ndonjë provë që ai ka marrë ndonjë miratim nga Komiteti për Komunitete i Kuvendit të Komunës.
11. Para pikave të lartpërmendura, paragrafi 54 jep një kundërthënie të theksuar në aktgjykim. Në fakt, në njërën anë "Gjykata konsideron që ky [propozim i Zëvendës Kryesuesit të Kuvendit të Komunës për Komunitete] ka qenë propozim i arsyeshëm që do të adresonte brengat legjitime të komuniteteve"; por, Gjykata nuk tërheq vazhdimësinë logjike në përcaktimin se cila emblemë është në përputhje me Kushtetutën. Në anën tjetër, Gjykata "urdhëron Komunën e Prizrenit të ndryshojë Statutin dhe emblemën e saj (..) për t'i vënë në përputhje me Kushtetutën dhe për të mos përjashtuar Komunitetet jo-shumicë", duke i dhënë kështu dukshëm hapësirë Komunës për ta siguruar atë përputhje dhe për të garantuar procesin e pjesëmarrjes së komuniteteve; por Gjykata qartësisht jep preferencën e saL për të mos thënë shenja të qarta, në lidhje me emblemën që duhet zgjedhur.
12. Dhënia e lirisë së plotë për Komunën në ndryshimin e emblemës do të thotë edhe liri e plotë në procesin e përcaktimit. por pa sugjeruar apo ndikuar në rezultatin e procesit vendim-marrës. Përndryshe, procesi i pjesëmarrjes së komuniteteve do të çrregullohej plotësisht nga qëndrimi sugjestiv i Gjykatës. Për mendimin tim, Gjykata nuk mund të injorojë nenin 53.2 të Ligjit mbi Vetë-Qeverisjen Lokale, i cili përcakton autoritetin e Komitetit për Komunitete i cili i "rekomandon kuvendit të komunës masat që duhet të ndërmerren për të siguruar jetësimin e dispozitave që kanë të bëjnë me nevojën e komuniteteve për t'u avancuar, shprehur, mbrojtur dhe zhvilluar identitetin e tyre etnik, kulturor, fetar dhe gjuhësor, si dhe për të siguruar mbrojtje adekuate të të drejtave të komuniteteve brenda komunës." Kështu, Gjykata nuk mund të injorojë, e aq më pak të çrregullojë të drejtën kushtetuese të komuniteteve jo-shumicë për të marrë pjesë në procesin vendim-marrës në lidhje me emblemën e komunës përmes Komitetit

për Komunitete, një prej dy komiteteve të përhershme të Kuvendit të Komunës.

13. Pra, konkludoj që referenca ndaj propozimit të lartpërmendur të bërë në paragrafin 12 do të ishte me vend dhe relevant sikur të ishte fakt që raportohet të ketë ndodhur. Megjithatë, fraza "Gjykata konsideron që ky ka qenë propozim i arsyeshëm që do të adresonte brengat legjitime të komuniteteve" duhet shlyer.
14. Në thelb, paragrafi 54 është në kundërthënie me arsyetimin dhe dispozitivin e aktgjykimit, dhe si i tillë nuk duhet të jetë pjesë e Aktgjykimit.

Gjyqtar

Almiro Rodrigues

Opinion i përbashkët mospajtuës

i gjyqtarit Almiro Rodrigues dhe gjyqtares Snezhana Botusharova

Lënda nr. KI 47/10

Naim Rustemi dhe 31 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës

vs.

Shkëlqesisë së Tij, Fatmir Sejdiu, President i Republikës së Kosovës

Ne e mirëpresim Aktgjykimin e Shumicës së Gjykatës Kushtetuese, por nuk pajtohemi për arsyet e mëposhtme:

1. Pranueshmëria e Kërkesës

1. Ne paraprakisht theksojmë se për sa i përket pyetjeve mbi kompetencat, ato kryesisht kanë të bëjnë me kufizimet e juridiksionit të Gjykatës. Si të tilla, ato ekzaminohen nga Gjykata në mocionin e tyre¹. Pyetja themelore është se, cili ose kush, është kompetent që të ngrejë një çështje dhe kundër kujt.

1.1 Palë e Autorizuar

2. Nuk kontestohet fakti se 32 deputetët e Kuvendit kanë nënshkruar Kërkesën, e cila u parashtrua pranë Gjykatës Kushtetuese më 25 qershor 2010. Kështu që, Kërkesa përmbante më shumë se numri minimal i 30 deputetëve të Kuvendit, siç përcaktohet në Nenin 113.6 të Kushtetutës. Megjithatë, më 29 qershor 2010, tre deputetë njoftuan Kryetarin e Gjykatës Kushtetuese se ata kishin tërhequr nënshkrimet e tyre nga peticioni i parashtruesve.

¹Shih, për shembull, jurisprudencën në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), *Blecic v Croatia*, No.59532/00, 8 mars 2006, paragrafi 67.

Në të njëjtën datë, më 29 qershor 2010, Gjykata njoftoi Presidentin e Republikës së Kosovës lidhur me parashtrimin e Kërkesës dhe e ftoi atë për të paraqitur përgjigjen e tij. Më 2 korrik 2010, një tjetër deputet tërhoqi nënshkrimin, ndërsa një tjetër deputet shtoi nënshkrimin e tij në listën e parashtruesve; më 5 korrik 2010, një deputet tjetër tërhoqi nënshkrimin e tij, dhe më 9 korrik 2010, edhe dy deputetë të tjerë tërhoqën nënshkrimet e tyre. Prandaj, në atë datë, lista e parashtruesve përmbante një numër prej 26 deputetëve, që do të thotë më pak se numri i kërkuar ligjor prej 30 deputetëve.

3. Një nga kriteret absolute dhe primare mbi pranueshmërinë e kërkesës është se duhet të parashtrohet nga një palë e autorizuar, për shembull, nga një parashtrues, i cili ka të drejtën juridike për të parashtruar një ankesë kushtetuese pranë Gjykatës Kushtetuese. Ky kriter është përcaktuar në Nenin 113.1 të Kushtetutës, i cili siguron se “Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para Gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar”.
4. Prandaj, pyetja që lind është nëse parashtruesit e Kërkesës, Naim Rustemi dhe 31 deputetët e tjerë, mund të konsiderohen si “palë e autorizuar” brenda kuptimit që përcaktohet në Nenin 113.1 të Kushtetutës. Në fakt, sipas Nenit 113.6 të Kushtetutës “Tridhjetë (30) a më shumë deputetë të Kuvendit të Kosovës, janë të autorizuar të ngrenë çështjen nëse Presidenti i Republikës së Kosovës ka kryer shkelje serioze të Kushtetutës”.
5. Kështu që, në shikim të parë, 32 deputetët mund të konsiderohen si palë e autorizuar kur kanë parashtruar Kërkesën më 25 qershor 2010. Megjithatë, një palë e tillë e autorizuar për të parashtruar një kërkesë në Gjykatën Kushtetuese ka nevojë për sqarim dhe duhet të plotësojë disa standarde ligjore: a është një grup me 30 deputetë, i cili përfaqësohet nga një prej tyre ose nga një përfaqësues ligjor nëpërmjet autorizimit përkatës, dhe a ekziston një kriter i tillë në sistemin ligjor të Republikës së Kosovës, apo secili prej tyre është i përfaqësuar në mënyrë individuale derisa numri i kërkuar të arrijë në 30? Shihet qartë, që ata nuk konsiderohen si grup duke u përfaqësuar nga njëri prej tyre².

²Shih: Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese Federale të Gjermanisë në rastin e Organstreit të datës 30 qershor 2009, paragrafi 169 dhe në vijim).

Në fakt, Kushtetuta e Gjermanisë dallon shumë qartë ndryshimin mes ankuesve që veprojnë si grup dhe përfaqësohen nga një person i autorizuar, ku tërheqja e disa anëtarëve, individë të grupit, nuk do të ndikojë mbi ligjshmërinë e palës së autorizuar. Megjithatë, ky nuk është rasti lidhur me kërkesën konkrete, sepse nuk ekziston një organ kolektiv që të tërheqë aplikimin, por janë një numër individësh, të cilët, së bashku, kanë shprehur dëshirën e tyre të ngrenë çështjen para Gjykatës Kushtetuese.

6. Pyetja e dytë është se nëse numri minimal i 30 deputetëve, jo vetëm që është i nevojshëm për të parashtruar një kërkesë para Gjykatës, por është e nevojshme të ruhet gjatë gjithë procedurës së Gjykatës, derisa të merret Vendimi përfundimtar.
7. Dy pyetjet e mësipërme janë shumë të rëndësishme dhe kërkojnë një përgjigje para se të vendosim mbi pranueshmërinë e lëndës. Lënia pa përgjigje e këtyre pyetjeve do të thotë se konkluzioni se ka qenë një palë e autorizuar do të mbetet pa asnjë bazë ligjore, edhe pse, numri i deputetëve ishte zvogëluar më poshtë se numri minimal që përcaktohet nga Kushtetuta.
8. Në përgjigjen e tij, Presidenti i Republikës argumenton se tërheqja e nënshkrimeve të disa deputetëve nga Kërkesa, që rezultoi me zvogëlimin e numrit të përkrahësve më poshtë se numri 30 (tridhjetë), do të thotë se grupi nuk mund të konsiderohet më si palë e autorizuar, siç përcaktohet në Nenin 113.6 të Kushtetutës.
9. Megjithatë, Shumica konkludoi se në atë datë, në të cilën u parashtrua Kërkesa, Gjykata ka pasur në procedim, një Kërkesë të vlefshme. Gjykata e ka pasur rastin në procedim që nga ajo datë dhe e ka mbajtur këtë të fundit, derisa është lëshuar Aktgjykimi. Prandaj, Shumica vendosi se Kërkesa është e pranueshme.
10. Ne nuk pajtohemi me konkluzionin e Shumicës, pasi që është në kundërshtim me parimin procedural të stabilitetit ligjor dhe paraqitjes konsekuente gjatë procedurave.

Ky parim përcakton se çështja duhet të jetë “e qëndrueshme” lidhur me personat, peticionin dhe arsyet për peticionin, që nga njoftimi i çështjes tek pala kundërshtarë deri në vendimin përfundimtar të çështjes³. Prandaj, kërkohet që të njëjtët parashtrues të qëndrojnë (të jenë të pranishëm/marrin pjesë) deri në fund të procedurës.

11. Prandaj, ne konsiderojmë se nuk ka pasur palë të autorizuar kur është dhënë Aktgjykimi. Meqenëse, kriteri absolut dhe themelor për të pasur një Kërkesë të vlefshme para Gjykatës Kushtetuese nuk është plotësuar, atëherë Kërkesa është e papranueshme.

1.2. Afatet kohore

12. Gjithashtu, është e padiskutueshme se në atë datë, në të cilën parashtruesit kanë parashtruar Kërkesën, ata pohojnë se me rastin e zgjedhjeve lokale të 17 nëntorit 2009, Presidenti i Republikës ka kryer shkelje të rëndë/serioze të Kushtetutës “gjithashtu duke vazhduar të mbajë njëkohësisht (sic) postin e Kryetarit të LDK-së, duke vepruar kështu në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës”. Parashtruesit e Kërkesës u ankuan në Gjykatë se shkelja e supozuar iu ishte bërë e ditur atyre gjatë procedurës së regjistrimit për zgjedhjet lokale, të cilat u mbajtën më 17 nëntor 2009.
13. Sipas Nenit 45 të Ligjit mbi Gjykatën Kushtetuese, Kërkesa duhej të ishte parashtruar brenda tridhjetë (30) ditëve, duke filluar që nga dita kur shkelja e supozuar e Kushtetutës nga Presidentit të ishte bërë publike.
14. Shumica konsideroi se “afati kohor prej 30 ditëve (...) për të parashtruar shkelje serioze/të rëndë në Gjykatën Kushtetuese, zbatohet për shkelje serioze që kanë qenë ngjarje që ndodhin vetëm “njëherë”, ose që kanë qenë shkelje të vazhdueshme që tashmë janë ndërprerë. Afati [kohor] nuk mund të aplikohet për shkelje serioze të cilat vazhdojnë”.
15. Ne nuk pajtohemi me këtë konsideratë.
16. Në fakt, kriteri i dytë që kërkesa të jetë e pranueshme është që të plotësojë kushtin për t’u parashtruar brenda afatit të përcaktuar ligjor ose afateve kohore. Kriteret e ngjashme ekzistojnë në procedurat e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ).

17. Në jurisprudencën e saj, GJEDNJ shpjegon kriterin e ***ratio legis*** që ankesa duhet të parashtrohet brenda gjashtë muajve nga data kur lëshohet vendimi i brendshëm përfundimtar (“i ashtuquajturi rregulli gjashtë-mujor”), duke deklaruar se “rregulli gjashtë mujor”, ka për qëllim që të sigurojë se rastet që ngrenë çështje në bazë të Konventës të shqyrtohen brenda një kohe të arsyeshme dhe të ndalohej që vendimet e kaluara të mos kontestohen më⁴. Ajo thekson kufizimet e përkohshme të mbikëqyrjes që kryen GJEDNJ-a dhe u tregon palëve periudhën përtej se cilës kjo mbikëqyrje nuk është më e mundshme⁵. Qëllimi i këtij rregulli është që njëkohësisht të ndalojë autoritetet, dhe persona të tjerë të interesuar, që të mos mbahen në gjendje pasigurie për një kohë të gjatë⁶. Së fundmi, GJEDNJ shpjegon se ky rregull është krijuar që të ndihmojë gjetjen e fakteve të çështjes; përndryshe, me kalimin e kohës, kjo do të bëhet edhe më e vështirë dhe ekzaminimi i drejtë i çështjes, si pasojë, do të bëhet problematike.
18. Duke zbatuar jurisprudencën e GJEDNJ-së, *mutatis mutandis*, në rastin konkret “Kërkesa duhet të parashtrohet brenda një afati prej tridhjetë (30) ditësh duke filluar që nga data që shkelja e supozuar e Presidentit të jetë bërë publike”, siç përcaktohet në Nenin 45 të Ligjit mbi Gjykatën Kushtetuese. Parashtruesit pohojnë se fakti se Presidenti i Republikës mban dy poste-si President dhe si Kryetar i LDK-së, është bërë i njohur gjatë procedurës së regjistrimit për zgjedhje lokale, të cilat u mbajtën më 17 nëntor 2009. Duke pranuar se, ashtu siç pohojnë parashtruesit, se Presidenti ka shkelur Kushtetutën që nga ajo ditë, atëherë ajo kërkesë është jashtë afatit dhe duhet të hidhet poshtë si e papranueshme. Parashtruesit duhet të kishin dorëzuar kërkesën në Gjykatën Kushtetuese përpara 17 dhjetorit 2009. Kjo ditë do të ishte dita e fundit e periudhës 30-ditore, e cila filloi të numërohej në ditën e mbajtjes së zgjedhjeve lokale, e cila është data kur shkelja e supozuar e Kushtetutës nga Presidenti është bërë publike.

³ Shih *Lewis v. Continental Bank Corp.*, U.S. 472, 477-78/1990/, cituar nga Presidenti në përgjigjen e tij lidhur me Kërkesën e Parashtruesve.

⁴ Shih: *Finucane v. The United Kingdom*, (dec.) No.29178/95, 2 korrik 2002; *Xv. France*, No. 9587/82, Vendimi i Komisionit me 13 dhjetor 1982, Vendime dhe Raporte (DR) 29, p.235.

⁵ Shih: *K v. Ireland*, ECHR-(GJEDNJ) No. 104116/83, 17 maj 1984.

⁶ *Alzery v. Sweden*, No. 10786/04, 26 dhjetor 2004.

19. Në të njëjtën mënyrë, Ligji i Gjykatës Kushtetuese Federale të Gjermanisë⁷ përmban një dispozitë të ngjashme, e cila shqyrton akuzimin e Presidentit Federal. Neni 50 përcakton se: "Akuzimi mund të kryhet vetëm brenda tre muajve të rrethanave, në të cilën bazohet, duke iu bërë i ditur organit që e akuzon".
20. Prandaj, këto afate kohore duhet të interpretohen në mënyrë shumë rigoroze dhe të zbatohen sipas standardeve ligjore.
21. Në fakt, është vështirë të kuptojmë se pse "koncepti i situatës së vazhdueshme"- do të ishte i zbatueshëm në këtë rast. Ky koncept ka të bëjë me situata që janë të vazhdueshme për shkak të mungesës së një mjeti efektiv të brendshëm, i cili mund t'i japë fund atyre ose sepse mjetet ekzistuese nuk janë më efektive. Kështu që, GJEDNJ zbaton konceptin e situatës së vazhdueshme vetëm kur shkelja e supozuar merr formën e punëve të shtetit në vend të një akti specifik ose vendimi, dhe kur nuk ka asnjë mjet lehtësimi në ligjin vendor kundër saj⁸. Prandaj, afati kohor gjashtë mujor nuk fillon të numërohet deri në përfundim të kësaj situate.
22. Koncepti i shkeljes së vazhdueshme ka një histori të gjatë ligjore në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, që nga rasti fillestar i *De Becker* (1958), duke kaluar në *Loizidou v. Turkey* (1996), *Cyprus v. Turkey* (2001) dhe *Ilascu and Others v. Moldova and Russia* (2004), deri në aktgjykimin e fundit të Dhomës së Madhe në *Varnava v. Turkey* (2009).
23. Duket qartë se dëshira e legjislaturës, kur ka miratuar Ligjin mbi Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës më 16 dhjetor 2008, ka qenë se ankesa për shkelje të supozuar të Kushtetutës nga ana e Presidentit të kryhet brenda 30 ditëve. Ky afat i qartë dhe i pa negociushëm është i kushtëzuar, përkatësisht, fillon që nga dita që shkelja e supozuar e Kushtetutës nga Presidenti është bërë publike. Kjo ditë është pikë e qartë dhe konkrete në kohën e ngjarjes.

⁷Bundesverfassungsgerichts-Gesetz, BVerfGG, Federal Law Gazette I p.243, ndryshuar se fundmi me Aktin e 16 korrikut 1998/ Federal Law Gazette I, faqe 1823.

⁸Shih, per shembull, *Ulke v. Turkey*, N 39437/98, 24 janar 2006.

24. Ne konsiderojmë se periudha e përcaktuar prej 30 ditësh ka si qëllim ruajtjen e stabilitetit në institucionet e vendit, duke themeluar disiplinë në ushtrimin e kësaj të drejte dhe në mbarëvajtjen e funksionimit të institucioneve të ndryshme kushtetuese, si dhe të sigurojë kontrollë dhe balancë efektive brenda sistemit kushtetues.
25. Prandaj, nëse pala e autorizuar nuk ve në përdorim këtë mjet juridik për çfarëdo arsye, mund të supozohet, se ata ose nuk konsiderojnë se ka pasur shkelje serioze, ose se ata nuk duan të procedojnë për çfarëdo arsye tjetër. Gjithsesi, koha për të sfiduar një shkelje serioze të Presidentit ka kaluar.
26. Asnjëri nuk mundet të hamendësojë se, pse deputetët nuk kanë reaguar brenda afateve të paraparë me ligj, nëse kanë konsideruar se Presidenti ka kryer shkelje serioze të Kushtetutës. Fakti se ai ishte dhe President i Republikës, dhe në të njëjtën kohë, ka mbajtur ‘postin’ e ngrirë” të Kryetarit të Partisë, ishte i ditur prej pohimit të tyre që më 17 nëntor 2009. Për më tepër, në kërkesën e tyre, ata nuk shpjegojnë se pse e konsiderojnë se afati 30-ditor i përcaktuar në Nenin 45 të Ligjit, miratuar nga deputetët e Kuvendit më 16 dhjetor 2008, nuk duhej të respektohej prej tyre, ose, se pse afati kohor mund të kapërcehej për shkak të ekzistencës së një situatë të vazhdueshme.
27. Në përfundim, ne konsiderojmë se sipas standardeve evropiane, nuk ekziston çështja e situatës së vazhdueshme në rastin konkret pasi ekzistonte një mjet lehtësimi, dhe prandaj, nuk ka shkelje të vazhdueshme të Kushtetutës nga Presidenti i Republikës. Kështu që, në bazë të fakteve të kësaj çështje dhe kritereve ligjore për pranueshmërinë, ne konkludojmë se kjo Kërkesë është e papranueshme. Për më tepër, këto kritere janë kushte absolute dhe papajtueshmëria me këto kritere ndikon substancialisht në jetëgjatësinë e çështjes.

1.3 Kërkesa nuk është arsyetuar

28. Deputetët e Kuvendit të Kosovës, të cilët nënshkruan Kërkesën, pohojnë se Presidenti ka kryer dhe vazhdon të kryejë një shkelje serioze të Nenit 88.2 të Kushtetutës, që ndalon Presidentin të ushtrojë ndonjë funksion politik partiak.
29. Deputetët, që kanë referuar çështjen para Gjykatës, konkludojnë se jo vetëm duke filluar nga 17 nëntori 2009, por që nga 9 tetori 2007,

partia LDK ka si Kryetar të zgjedhur, z. Fatmir Sejdiu, Presidentin e Republikës së Kosovës. Ata supozojnë se kjo situatë përbën shkelje serioze të Kushtetutës. Megjithatë, nuk është paraqitur asnjë bazë, e cila i lejon ata që të konkludojnë se “Presidenti i Republikës së Kosovës ka kryer shkelje serioze të Kushtetutës”².

30. “Kërkesa duhet të arsyetohet dhe duhet t’i bashkëngjitet dokumentacioni mbështetës dhe informacionet e nevojshme¹⁰, ndërsa “Kërkesa duhet të përfshijë” një arsyetim procedural dhe substancial të Kërkesës, dhe informacionin mbështetës dhe dokumentacionin”¹¹.
31. Për më tepër, sipas jurisprudencës themeluar nga GJEDNJ-a, parashtruesi nuk mbartë barrën fillestare që të paraqesë evidencë të arsyeshme dhe bindëse që të mbështesë shkeljen e supozuar¹². Nëse një parashtrues nuk mundet të arsyetojë pohimet e tij/saj, GJEDNJ-a e deklaron çështjen të papranueshme si të pabazë.
32. Në mënyrë të ngjashme, jurisprudenca e kohëve të fundit e Gjykatës paraqet shembuj të kërkesave, ku Gjykata ka vendosur se parashtruesit kanë nevojë që të arsyetojnë pohimet e tyre të shkeljes së Kushtetutës me qëllim që kërkesa të shpallet si e pranueshme¹³.
33. Për më tepër, për hir të drejtësisë dhe barazisë së armëve, argumentet e Palës Kundërshtare, Presidentit të Republikës së Kosovës, duhej t’ju ishin komunikuar parashtruesve të Kërkesës për komente, ose edhe më shumë, duhej të ishin diskutuar në një seancë dëgjimore publike. Duke mos vepruar kështu, Gjykata ka marrë pjesë *ex-officio* duke iu përgjigjur observimeve të Presidentit, në këtë mënyrë, duke mos ju dhënë asnjë mundësi parashtruesve që të marrin një qëndrim lidhur me përgjigjen e Presidentit.

⁹Neni 113.6 i Kushtetutës.

¹⁰ Neni 22.1 i Kushtetutës.

¹¹Neni 29(1) (f) dhe (g) i Rregullores se Punes se Gjykatës Kushtetuese.

¹² Shih: per shembull, *mutatis mutandis*, *Ocic v Croatia*, No. 46306/99, 1999; *Halford v UK*, No. 20605/92, 25 qershor 1997).

¹³ Shih: per shembull, *Misin Beqiri vs. Ministry of Health*, Case No. KI.17/09, Vendimi mbi Papranueshmërinë me 22 prill 2010; *Ahmet Arifaj vs. Municipality of Klina*, Case No. KI. 23/09, Vendimi mbi Papranueshmërinë i 20 prillit 2010).

34. Lidhur me këtë, ne dëshirojmë t'i referohemi Nenit 55 (Akuzimi i Presidentit Federal) të Ligjit Gjerman mbi Gjykatën Kushtetuese¹⁴, i cituar më lart, i cili tregon qartësisht se paraqitja e evidencave është një pjesë themelore e procedurës së akuzimit para Gjykatës Kushtetuese Federale Gjermane.
35. Nga ana tjetër, argumentet e Shumicës për sa i përket rolit të partive politike dhe Presidentit, dhe influencës politike të një Presidenti aktiv në emër të partisë së tij, janë kryesisht të sakta kur konsiderohen në përgjithësi ose në parim. Por, në të njëjtën vijë të bisedës së përgjithshme, dikush mund të spekulojë se edhe pas dorëheqjes së plotë të Presidentit nga posti partiak ose edhe nga anëtarësia e partisë, ai do të mundej dhe do të vazhdonte të kishte asociim me të njëjtën parti dhe politikat e saj, edhe pse nuk mund të ishte më shumë aktiv në parti, edhe duke mos mbajtur asnjë post partiak.
36. Kushtetuta e ndalon Presidentin e Republikës nga "ushtrimi i çfarëdo funksioni të ndonjë posti partiak". Cilat ishin aktet konkrete, sjellja ose dëmet për të arsyetuar dhe konfirmuar shkeljen e supozuar të Palës Kundërshtare? Parashtruesve duhej t'ju jepej mundësia për t'u përgjigjur, nëse ata dëshironin. Si mund të quhet mbajtja e një posti të udhëheqësit, si ushtrim i një funksioni politik partiak, edhe pse "i ngrirë" sipas Presidentit? Këtyre pyetjeve nuk u është dhënë përgjigje me anë të evidencës. Kjo evidencë nuk ka qenë as e pranishme, as e analizuar dhe as e interpretuar, me qëllim që të përcaktojmë faktet të cilat përbëjnë një shkelje serioze.

¹⁴Neni 55(1): Gjykata Kushtetuese Federale do të vendosë në bazë të procedurës verbale.

(2) Presidenti Federal do të thirret në procedurën verbale. Në fletëthirrje, ai do të njoftohet se procedura do të mbahet edhe në mungesë të tij, nëse ai nuk paraqitet pa dhënë asnjë arsye ose pa marrë leje për një arsye të përshtatshme. (3) Gjatë procedurës, përfaqësuesi i organit që bën aplikimin, duhet që të shqiptojë me zë të lartë akuzën e nxjerrjes para gjyqit. (4) Pas kësaj, Presidentit Federal do t'i jepet mundësia që të japë një deklaratë lidhur me nxjerrjen para gjyqit. (5) Pastaj, do të paraqitet evidenca. (6) Në fund të procedurës, përfaqësuesi i organit që është përgjegjës për nxjerrjen para gjyqit, do të prezantojë justifikimin e tij dhe Presidenti Federal do të prezantojë argumentet mbrojtëse. Ai do të mbajë fjalën e fundit.

37. Për më tepër, një interpretim kushtetues i Nenit 88.2 të Kushtetutës vlen për t'u cituar, sidomos në aspektin e fjalëve që përdoren në Nenin 9.2.7 të Kornizës Kushtetuese për Vetë-qeverisjen e Përkohshme në Kosovë, e cila ka qenë e zbatueshme deri me hyrjen në fuqi të Kushtetutës ekzistuese. Kjo dispozitë përcakton: "Presidenti i Kosovës nuk do të mbajë asnjë post tjetër ose profesion".
38. Qartësisht, formulimi i fjalëve që përdoren për bazat e papajtueshmërisë, ngre një çështje kushtetuese e cila meriton bisedime dhe interpretim.
39. Prandaj, me keqardhje, ne kemi vështirësi që të bashkohemi me mënyrën e mendimit që është dhënë në pjesën e arsytimit të Aktgjykimit.
40. Ne arrijmë në përfundimin se Kërkesa nuk është arsyetuar dhe duhet të shpallej e papranueshme si qartazi e pabazë.

2. Përdorimi i *travaux preparatoires* (punë përgatitore)

41. Kjo çështje ngre shumë pyetje, të cilat duhej të sqaroheshin duke konsultuar *travaux preparatoires* (punë përgatitore) lidhur me hartimin e Kushtetutës dhe Ligjit mbi Gjykatën Kushtetuese. Ne kemi kërkuar shumë për këto dokumente, por pa dobi. Ne konsiderojmë se, si në të gjitha praktikat e shumë shteteve, dhe në veçanti, konsultimi i *travaux preparatoires* do të kishte qenë shumë i dobishëm për interpretimin e Kushtetutës dhe të ligjit. Edhe pse ky parim shpjegohet si shpjegues, është e drejtë ndërkombëtare zakonore¹⁵. Praktika e përdorimit të *travaux preparatoires* reflektohet, gjithashtu, edhe në jurisprudencën e GJEDNJ-së, në të cilën Gjykata e Strasburgut deklaroi se¹⁶ nenet 31-33 të Konventës së Vjenës mbi Ligjin e Traktateve, data 23 maj 1969, duhet të udhëheqin në interpretimin e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

¹⁵ Shih: *Bankovic and others v Belgium and 16 other Contracting States*, No . 52207/99, 12 December (dhjetor) 2001, GC, /2007/, paragrafi 35/.

¹⁶ *Golber v UK* /N 4451/70, 21 shkurt 1975, paragrafi 29.

Parimi i *travaux preparatoires* mund të përdoret për të ndihmuar në zgjidhjen e dykuptimësisë në një tekst, të konfirmojë një kuptim dhënë nga atributi i përdorimit të rregullave të tjera ose për të shmangur një absurditet.

42. Fatkeqësisht, lidhur me Kërkesën konkrete, ky mjet shumë i rëndësishëm nuk ka qenë në dispozicionin tonë.

3. Konkluzioni

43. Për arsytet e mësipërme, ne nuk pajtohemi me konkluzionin e Shumicës, e cila gjen se ka shkelje të Kushtetutës, dhe me respekt, paraqesim opinionin tonë mospajtues.

Prishtinë, më 12 tetor 2010

Gjyqtari

Almiro Rodrigues

Gjyqtarja

Snezhana Botusharova

Rasti Nr. KO 29/11

Parashtrues

Sabri Hamiti dhe deputetë të tjerë të Kuvendit të Kosovës

**Vlerësim i kushtetutshmërisë të Vendimit të Kuvendit të
Republikës së Kosovës**

Nr. 04-V-04

Lidhur me zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës

të 22 shkurtit 2011

30 mars 2011

Mendim mospajtues i gjyqtarëve

Robert Carolan dhe Almiro Rodrigues

Me respekt nuk pajtohemi me dy vendimet dhe konkluzionet e shumicës së Gjykatës në këtë kërkesë.

FAKTET

Parashtruesit dhe pala kundërshtare pajtohen lidhur me faktet në vijim:

1. Më 22 shkurt 2011, Kuvendi i Kosovës filloi votimin për zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës.
2. Kandidati i vetëm i nominuar ishte z. Behgjet Pacolli.
3. Kur u mbajt votimi i parë, 67 deputetë ishin të pranishëm në Kuvend. Z. Pacolli mori 54 vota.
4. Kur u mbajt votimi i dytë, 67 deputetë ishin të pranishëm. Z. Pacolli mori 58 vota.
5. Para se të mbahej votimi i tretë, pati një pauzë prej më pak se një orë.

6. Kur u mbajt votimi i tretë, së paku 65 deputetë ishin të pranishëm. Z. Pacolli mori 62 vota.

Do t'i shqyrtojmë tri çështjet kryesore: (1) kuorumi, (2) numri i kandidatëve, dhe (3) pasojat e Aktgjykimit të Gjykatës.

(1) KUORUMI

Shumica, së paku në mënyrë implicite, gabimisht konkludon që përkufizimi i “kuorumit” për qëllime të zgjedhjes së një Presidenti është njësoj si numri minimal i votave që një kandidat i suksesshëm për President duhet t'i marrë për t'u zgjedhur dhe që ai numër minimal i votuesve duhet të jetë i pranishëm me rastin e hapjes së seancës.

Kuorumi dallon nga votimi. Kuorumi është “numri minimal i anëtarëve të një kuvendi votues të nevojshëm për ta zhvilluar punën”.

¹ Votimi² nga anëtarët e organit legjislativ është pjesë e punës së atij organi legjislativ. Rregullat që zbatohen për cilindo prej tyre mund të jenë, dhe shpesh janë, të ndryshme.

Në përputhje me **paragrafin 3 të nenit 69 të Kushtetutës**, “Kuvendi i Kosovës ka kuorum kur janë të pranishëm më shumë se gjysma (1/2) e të gjithë deputetëve të Kuvendit”. Ajo dispozitë është e vetmja që e përmend kuorumin. Rregullorja e punës së Kuvendit gjithashtu përcakton të njëjtin kuorum për Kuvend, që është më shumë se gjysma e të gjithë deputetëve (61 deputetë). Ai kuorum mbetet i pandryshuar gjatë seancës³, pavarësisht punës së Kuvendit, edhe pse numri minimal i votave për ta marrë një vendim mund të ndryshojë⁴.

Prandaj, në përputhje me Kushtetutën dhe Rregulloren e punës së Kuvendit, kandidati i suksesshëm për President, qoftë në votimin e parë apo të dytë të anëtarëve të Kuvendit, duhet t'i marrë votat e dy të tretës (80 deputetë) së votave të të gjithë deputetëve.

¹ Rregullorja e Rendit e sapo rishikuar e Robert-it, botimi i dhjetë (2000), f. 20.

² Sistemi i votimit përmban rregulla për votim të vlefshëm, dhe si numërohen dhe grumbullohen votat për ta dhënë rezultatin përfundimtar (“Sistemi i votimit” nga Wikipedia).

³ “Seancë e kuvendit është takimi i cili, edhe pse mund të zgjasë me ditë të tëra, është në të vërtetë një takim (...) Shtyrjet e ndërmjetme prej ditës në ditë, ose pushimet që merren gjatë ditës, nuk e prishin vazhdimësinë e mbledhjeve, që në të vërtetë përbëjnë një seancë”. (Rregullorja e Rendit e Robert-it, Nen. XI. Të ndryshme, [63](#). Seancë).

⁴ Shih nenin 20, 68, 69, 76, 90, 91 dhe 131 të Kushtetutës.

Në votimin e tretë, për t'u zgjedhur si President, kandidati i suksesshëm duhet t'i marrë votat e më shumë se gjysmës së të gjithë deputetëve (61 deputetë).

Në këtë rast, më 22 shkurt 2011, pati kuorum të Kuvendit pasi të pranishëm ishin ndërmjet 67 dhe 65 deputetë.

Kandidati i vetëm i propozuar nuk mori dy të tretat e votave të nevojshme (votën e 80 deputetëve) që i nevojiteshin për t'u zgjedhur President qoftë në votimin e parë apo të dytë. Megjithatë, në votimin e tretë, kandidati i vetëm i nominuar mori 62 vota, më shumë se numri minimal i votave (61) që kërkohet me Kushtetutë dhe Rregullore të punës.

Hartuesit e Kushtetutës e kuptuan qartë dallimin ndërmjet kuorumit dhe votimit duke i lejuar Kuvendit që në votimin e tretë ta zgjidhte Presidentin me një numër tjetër të votave minimale por kurrë duke mos e ndryshuar numrin e anëtarëve që duhej të ishin të pranishëm për të pasur kuorum.

Rregulli që do të kërkonte kuorumin e 2/3 do t'i lejonte një pakicë të vogël të anëtarëve (41 deputetë) ta pengonte shumicën e parlamentarëve për të kryer punë dhe vullnetin e shumicës thjesht duke refuzuar të takohej dhe ta bënte punën për të cilën e kishin dhënë betimin. Kjo do ta pengonte shumicën për t'i kryer detyrat për të cilat ishin zgjedhur. Në të vërtetë, kjo do t'i lejonte pakicës ta bllokonte vullnetin demokratik të shumicës. Kjo gjithashtu do ta pengonte Kuvendin që të vepronte në përputhje me **paragrafin 4 të nenit 86 të Kushtetutës** dhe ta zgjidhte Presidentin me shumicën e thjeshtë të votave të deputetëve të Kuvendit. Një interpretim i tillë do ta bënte **paragrafin 4 të nenit 86** të pakuptimtë. Hartuesit e Kushtetutës, posaçërisht, e kanë hartuar Kushtetutën në atë mënyrë për ta penguar pakicën që ta bllokonte vullnetin e shumicës.

(2) NUMRI I KANDIDATËVE

Shumica gabimisht konkludon që Kuvendi nuk mund ta zgjedhë Presidentin e Republikës nëse nuk ka më tepër se një kandidat.

Kandidati i suksesshëm duhet të nominohet nga së paku 30 deputetë të Kuvendit. Prandaj, maksimumi prej katër dhe minimumi prej një kandidati mund të ekzistojë. Megjithatë, shumica gabimisht konkludon që Kuvendi i Kosovës nuk mund ta zgjedhë Presidentin e Kosovës nëse së paku 60 deputetë nuk i nominojnë dy kandidatë të ndryshëm për President, madje edhe në një situatë në të cilën ata të gjithë mund ta mbështesin vetëm njërin kandidat.

Siç pranon shumica në mënyrë implicite, sipas interpretimit të vet të Kushtetutës, Presidenti i parë i Kosovës, Shkëlqesia e tij, i ndjeri Ibrahim Rugova, nuk do të mund të zgjidhej President i Republikës me aklamacion në vitin 2002 edhe po të ishte ai vullneti i tërë Kuvendit. Natyrisht, hartuesit e Kushtetutës kurrë nuk synuan një përfundim të tillë.

Në të vërtetë, shumica qartë e keqkupton **paragrafin 5 të nenit 86 të Kushtetutës** duke thënë që duhet të jenë së paku dy kandidatë. Po të kërkohej dy kandidatë, hartuesit e **paragrafit 5 të nenit 86** do të mund të kishin thënë dhe do të thoshin se do të ketë më tepër se një kandidat. Në të vërtetë, në paragrafin tjetër të **Kushtetutës, paragrafi 6**, të njëjtit hartues të Kushtetutës posaçërisht përdorën fjalën “duhet” kur thanë çka do të ndodhte nëse asnjëri kandidat nuk zgjidhej në raundin e tretë. Për më tepër, shprehja “asnjëri” në paragrafin 5 të nenit 86 të Kushtetutës, sipas të gjithë fjalorëve do të thotë “një apo më shumë”.

Pra, “asnjëri kandidat” do të thotë “një apo më shumë kandidatë”. Përveç kësaj, kombinimi i dy të tretat (2/3) për dy votimet e para dhe shumica për votimin e tretë gjithashtu do të thotë që mund të ketë një apo më shumë kandidatë, pasi dy të tretat (2/3) është më përkatëse për balotazh kur ka më tepër se një kandidat dhe shumica për vetëm një kandidat.

Fakti që hartuesit e Kushtetutës zgjodhën të mos e përdornin të njëjtën gjuhë askund në Kushtetutë lidhur me atë se sa kandidatë duhet të nominohen në mënyrë që Kuvendi ta zgjedhë Presidentin, por posaçërisht përdori fjalën “duhet” sa u përket pasojave të Kuvendit për moszgjidhjen e Presidentit në votimin e tretë, qartazi do të thotë që hartuesit kurrë nuk menduan se duhej të kishte më tepër se një kandidat për President para se Kuvendi të mund ta zgjedhë Presidentin.

Nuk ka kriter se duhet të ketë më tepër se një kandidat për President para se Kuvendi të mund ta zgjedhë Presidentin. Kriteri i vetëm në Kushtetutë në këtë drejtim është se nëse dy kandidatë janë në votimin e tretë, kandidati fitues duhet ta marrë shumicën e votave të deputetëve (61).

Po të interpretohej Kushtetuta se kërkohen së paku dy apo më shumë kandidatë, kjo do të mund ta pengonte zgjedhjen e një kandidati që shumica e deputetëve të zgjedhur të Kuvendit e mbështetën. Po të ekzistonte një kriter i tillë, ai do të mund të përmbushej lehtë me 30 deputetë të tjerë të cilët e nënshkruajnë një dokument me të cilin e mbështesin kandidatin tjetër, por që më pas votojnë për kandidatin e pëlqyer.

Ky interpretim do të krijonte mashtrim dhe përqeshje të sistemit zgjedhor për zyrën më të lartë të zgjedhur në Kosovë. Hartuesit e Kushtetutës nuk mund të kenë menduar një përfundim të tillë jologjik. Gjykata Kushtetuese nuk ka kompetencë për t'i urdhëruar Kuvendit që të nominojë më tepër se një kandidat.

Me pak fjalë, ajo që u tha më lart është në përputhje me interpretimin sistematik dhe teleologjik që lejon konkludimin se qëllimi kryesor i Kushtetutës është garantimi i funksionimit të rregullt të institucioneve politike dhe sigurimi i stabilitetit politik.

Për më tepër, nuk mund të themi që, të qenët President, kreu i shtetit dhe garantues i unitetit të popullit people⁵, Presidenti duhet patjetër të zgjidhet me dy të tretat e votave të të gjithë deputetëve, pasi, madje edhe kur ka më shumë se një kandidat, Presidenti mund të zgjidhet vetëm me shumicë të votave.

(3) PASOJAT E AKTGJYKIMIT TË GJYKATËS

Shumica konkludon, dhe kjo është e padiskutueshme, që më 22 shkurt 2011, Kuvendi mbajti tri raunde të votimit për Zyrën e Presidentit të Republikës. Në fund të votimit të tretë, Kryetari i Kuvendit deklaroi që z. Behgjet Pacolli ishte zgjedhur President. Kjo Gjykatë nuk mund t'i ndryshojë faktet apo të rishkruajë çfarë ka ndodhur më 22 shkurt. Tri herë u votua për Zyrën e Presidentit të Republikës. Kryetari i Kuvendit më pas e shpalli z. Behgjet Pacolli President të zgjedhur të Republikës së Kosovës

Nëse ai proces zgjedhor e shkeli Kushtetutën, paragrafi 6 i Kushtetutës është shumë i qartë sa i përket mjetit kushtetues:

Nëse në votimin e tretë, asnjëri kandidat nuk zgjidhet President i Republikës së Kosovës, shpërndahet Kuvendi dhe shpallen zgjedhjet e reja, të cilat duhet të mbahen brenda dyzet e pesë (45) ditësh (theks i shtuar).

Gjykata Kushtetuese nuk ka kompetencë për t'i urdhëruar Kuvendit që t'i nominojë së paku dy kandidatë për Zyrën e Presidentit ose për t'i urdhëruar Kuvendit të rivotojë për të katërtën herë.

Megjithatë, që në fillim, kur Gjykata përcakton që ka pasur shkelje të Kushtetutës në procedurën zgjedhore të Kuvendit, Kushtetuta më pas

⁵Neni 83 [Statusi i Presidentit] i Kushtetutës thotë që "Presidenti është kreu i shtetit dhe përfaqëson unitetin e popullit të Republikë së Kosovës".

urdhëron që Kuvendi të shpërndahet dhe zgjedhjet e reja të përgjithshme të mbahen brenda dyzet e pesë ditësh.

Duke deklaruar që procesi zgjedhor i 22 shkurtit 2011 e shkeli Kushtetutën, kjo Gjykatë deklaroi që Kuvendi nuk e kishte zgjedhur Presidentin pas raundit të tretë të votimit. Kushtetuta më pas urdhëron shpërndarjen e Kuvendit dhe zgjedhjet e reja të përgjithshme brenda 45 ditësh.

Vendimi i sotëm i gabuar i Gjykatës, që nuk mund të jetë pa pasoja, e imponon atë përfundim. Gjykata, duke deklaruar thjesht që procesi zgjedhor i 22 shkurtit 2011 e shkeli Kushtetutën, në mënyrë implicite pranon që nuk ka kompetencë për t'i urdhëruar Kuvendit që të rivotojë. Pasi Gjykata nuk ka kompetencë për ta shpallur zgjedhjen jokushtetuese pa asnjë mjet, vendimi i shumicës imponon shpërndarjen e Kuvendit dhe zgjedhjet e reja të përgjithshme.

Dorëzuar me respekt,

Robert Carolan

Almiro Rodrigues

Gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës

MENDIM MOSPAJTUES

në

Rastin Nr. KI 55/09

Parashtrues

N.T.SH. Meteorit

**Vlerësim i kushtetutshmërisë të Vendimit të Gjykatës
Supreme të Kosovës, Nr. 2407/2006, të 30 shtatorit 2009**

Gjyqtarët

Almiro Rodrigues

dhe

Gjyljeta Mushkolaj

Përshëndesim aktgjykimin e shumicës së Gjykatës Kushtetuese, por me respekt, nuk pajtohem që “nuk ka pasur shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe nuk ka pasur shkelje të së drejtës së parashtruesit për gjykim të drejtë, siç parashihet në nenin 6.1 të Konventës”.¹

1. Në të vërtetë, aktgjykimi konkludoi që “nuk ka prova në këtë rast që Gjykata Supreme i ka vlerësuar provat e paraqitura nga parashtruesi në mënyrë të padrejtë apo të pasaktë. Parashtruesi ka dështuar të dëshmonte që Gjykata Supreme e ka shkelur nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe nenin 31 të Kushtetutës”.²
2. Me tërë respektin, ne mendojmë që ka pasur (a) shkelje të së drejtës për dëgjim të drejtë, (b) shkelje të së drejtës së parashtruesit për gjykim të drejtë, dhe (c) një konkluzion tjetër është dashur të arrihej.

¹ Paragrafi 24 i Aktgjykimit.

² Paragrafi 23 i Aktgjykimit.

(a) Shkelja e të drejtës për dëgjim të drejtë

3. Sipas mendimit tonë, ka pasur shkelje të drejtësisë, pasi argumenti i paraqitur nga parashtruesi nuk është dëgjuar dhe atij nuk i është dorëzuar vendimi i arsyetuar. E drejta për t'u dëgjuar nuk është pikërisht e lidhur me shqyrtimin verbal, por kryesisht me përgjigjen e Gjykatës për një argument të parashtruesit, të përfshirë me shkrim. Parashtruesi paraqiti argumentin si në vijim.
4. Parashtruesi pohoi, në njërën anë, për “metodën e përcaktimit të qarkullimit shtesë dhe obligimeve që dalin deri tani, duke pohuar që argumentet që janë bindëse fare nuk janë marrë parasysh”³, por as provat mbështetëse.
5. Parashtruesi më tej pohoi që “vlerësimi i inspektorëve kontrollues nuk ishte i drejtë sepse sipas të dhënave në dosje ishin deklaruar më tepër mallra se që ishin në dispozicion në stok.”⁴
6. Në anën tjetër, parashtruesi pohon që Gjykata Supreme e Kosovës⁵ konkludoi në Aktgjykimin e vet të parë se “situata faktike nuk ishte përcaktuar dhe se kishte mospajtim ndërmjet provave dhe vendimit të kontestuar lidhur me obligimin përkatës tatimor të paditësit”.
7. Përveç kësaj, parashtruesi pohon që Bordi i Pavarur për Rishqyrtime nuk i ka zbatuar udhëzimet e Gjykatës Supreme se “si duhet të veprojë organi vendimmarrës për nxjerrjen e një vendimi të ligjshëm, shqyrtimin e provave, dhe të fakteve vendimtare”⁶.
8. I takon Gjykatës Supreme t'i korrigjojë gabimet e gjykatave më të ulëta. Duke vepruar sipas atij obligimi, Gjykata Supreme, duke iu përgjigjur argumentit të parashtruesit, identifikoi në aktgjykimin e vet të parë një shkelje se **“situata faktike nuk ishte përcaktuar dhe se kishte mospajtim ndërmjet provave dhe vendimit të kontestuar lidhur me obligimin përkatës tatimor të paditësit”**.

³ Shih ankesat drejtuar Gjykatës Supreme kundër vendimeve Nr. 426, të 9 janarit 2004, dhe Nr. 62/2004, të 14 prillit 2004.

⁴ Shih ankesat drejtuar Gjykatës Supreme kundër vendimit A. Nr. 439/06, të 24 gushtit 2006.

⁵ Aktgjykimi A. Nr. 233/04, i 17 majit 2006.

⁶ Shih ankesat drejtuar Gjykatës Supreme kundër vendimit A. Nr. 439/06, të 24 gushtit 2006.

Prandaj, Gjykata Supreme ia ktheu rastin Bordit të Pavarur për Rishqyrtime duke e udhëzuar si duhej të vepronte për nxjerrjen e “një vendimi të ligjshëm, shqyrtimin e provave, dhe të fakteve vendimtare”.

9. Ndërkohë, parashtruesi pohon që Aktgjykimi i dytë i Gjykatës Supreme⁷ “është në kundërshtim me aktgjykimin A. Nr. 233/04 të gjykatës së njëjtë”, dhe “dosjet që tregojnë se e drejta e parashtruesit për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, e paraparë me nenin 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës” ishte shkelur.
10. Çështja kryesore që duhet të diskutohet është nëse vendimi i Bordit të Pavarur për Rishqyrtime e përcaktoi drejt **“situatën faktike”** dhe e eliminoi **“mospajtimin ndërmjet provave dhe vendimit të kontestuar** lidhur me obligimin përkatës tatimor të paditësit”.
11. Sipas mendimit tonë, një përcaktim dhe eliminim i tillë nuk ishte bërë nga Bordi i Pavarur për Rishqyrtime. Prandaj, aktgjykimi i parë i Gjykatës Supreme, ose ishte i saktë për vënien në pah të këtyre të metave ose nuk ishte. Nëse po, ai do të duhej ta mbështeste të njëjtën pikëpamje lidhur me vendimin e dytë të Bordit të Pavarur për Rishqyrtime. Konsiderojmë që vendimi i dytë⁸ nuk i plotësoi të metat, siç do të sqarojmë më tutje.
12. Në fakt, krahasimi i dy vendimeve të Bordit të Pavarur për Rishqyrtime⁹ tregon me sa vijon:
 - i) E njëjta fjali “Librat e blerjes dhe të shitjes nuk ishin mbajtur në përputhje me rregulloren”, paraqitet në të dy vendimet (62/2004, i pari, dhe 439/2006, i dyti);
 - ii) Gjithashtu e njëjta fjali “Inspektori tatimor ka vepruar drejt dhe e ka zbatuar metodën e analizimit të furnizimit dhe të shitjeve të deklaruar në lidhje me kronologjinë e datës së përdorimit”, paraqitet në të dy vendimet (62/2004, i pari, dhe 439/2006, i dyti);
 - iii) Fjalja “Bazuar në nenin 7 dhe 2 të Rregullores 2000/20 dhe nenin 9.1 dhe 9.4 të Rregullores 1/2000, nenin 8 dhe 27 të Rregullores 2001/11 dhe nenin 10 të Rregullores 2002/4, gjatë rivlerësimit të tatimit konkluduar që vendimi i Administratës Tatimore është i vlefshëm dhe gjobat që i ishin

⁷ A. Nr. 2407/2006, i 30 dhjetorit 2009.

⁸ Vendimi A. Nr. 439/2006, i 24 gushtit 2006.

⁹ Nr. 62/2004 14, i prillit 2004, dhe A. Nr. 439/2006, i 24 gushtit 2006.

llogaritur taksapaguesit gjithashtu janë të vlefshme”, paraqitet vetëm në vendimin e dytë (439/2006). Siç duket, ky është modifikimi i vetëm i bërë nga Bordi i Pavarur për Rishqyrtime për të vepruar në përputhje me udhëzimet e Gjykatës Supreme.

Vërejmë që të gjitha këto fjali janë përfundimtare dhe pa asnjë analizë faktike dhe ligjore.

13. Përveç kësaj, vendimi i dytë i Gjykatës Supreme¹⁰ përmban këtë deklaratë: “pas analizimit të provave të paraqitura nga pronari i taksapaguesit dhe analizimit të ankesës me shkrim dhe pas dëgjimit të përfaqësuesve të Administratës Tatimore dhe provave të paraqitura në seancën dëgjimore, i shqyrtoi provat e paraqitura nga të dy palët, në të cilën e përcaktoi situatën faktike në vijim”.
14. Megjithatë, as faktet nuk ishin përcaktuar, as analiza ligjore nuk ishte bërë para se të konkludohej siç u cek në paragrafin 12 i) dhe ii) më lart. Në anën tjetër, fjalia e përmendur në paragrafin 12 iii) është vetëm referencë e thjeshtë ligjore për dispozita të caktuara ligjore pa kurrfarë kuptimi praktik ligjor, pa asnjë lidhje me situatën e përcaktuar faktike. Është vetëm një formulë stereotipike.
15. Siç duket, shumica ishte e kënaqur që fjalia e sipërpërmendur në paragrafin 12 iii) mjaftonte për ta mbushur boshllëkun e përmendur në aktgjykimin e parë të Gjykatës Supreme, pasi në të përmendeshin dispozitat ligjore dhe rregulloret në fuqi.
16. Megjithatë, deklarata/fjalia në paragrafin 12 iii), pa saktësuar cilat fakte ishin përcaktuar dhe cila ishte marrëdhënia me dispozitat e përmendura ligjore, nuk është asgjë tjetër përveç një formulë boshe ose joshprehëse. Në anën tjetër, argumenti i ngritur dhe provat e paraqitura nga parashtruesi kanë të bëjnë me thelbin e rastit. Prandaj, argumenti i parashtruesit duhej të ishte marrë, analizuar dhe konkluduar në mënyrë eksplicite.

(b) Shkelja e të drejtës së parashtruesit për gjykim të drejtë

17. Parashtruesi ka të drejtë ta marrë vendimin e gjykatës në përputhje me ligjin. Kjo e drejtë përfshin obligimin e gjykatave për t'i ofruar arsyet për vendimet e tyre me shkaqe të arsyeshme në të dy nivelet, atë procedural dhe material. E drejta për të pasur arsye për vendime gjyqësore kërkon

¹⁰ A. Nr. 2407/2006, i 30 dhjetorit 2009.

sqarime me *arsye bindëse dhe ligjërish të konstruktura mirë* për vendimin e marrë për secilin rast individual, i cili duhet t'i përfshijë *kriteret ligjore dhe elementet faktike* në mbështetje të vendimit.

18. Vendimet, që janë në shqyrtim e sipër në këtë rast, ishin nxjerrë kryesisht nga Bordi i Pavarur për Rishqyrtime. Edhe pse Bordi i Pavarur për Rishqyrtime nuk është tribunal, fjala “gjykatë”¹¹ duhet të kuptohet në kuptimin e vet më të gjerë, në përputhje me jurisprudencën e GJEDNJ-së. Prandaj, të gjitha organet, duke përfshirë Bordin e Pavarur për Rishqyrtime, që duhet t'i zgjidhin kontestet administrative duhet të konsiderohen si gjykata. Si rrjedhojë, e drejta për gjykim të drejtë duhet të garantohet edhe në procedurat para këtyre organeve.
19. Përveç kësaj, Ligji Nr. 2004/48 mbi administratën tatimore dhe procedurat¹², që e themeloi Bordin e Pavarur për Rishqyrtime¹³, pranon të drejtën për gjykim të drejtë, siç garantohet me KEDNJ dhe Kushtetutë.
20. Në anën tjetër, neni 3 i Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut Nr. 2000/7¹⁴ kërkon që Bordi “udhëheq seancën e shqyrtimit dhe i shqyrton dëshmitë relevante, dokumentet dhe provat e tjera të paraqitura nga tatimpaguesi dhe Administrata e taksave” (neni 3.1), dhe thotë që “Bordi e diskuton rastin në formë jurie dhe i njofton palët për vendimet e tij, **të shoqëruara me arsyet e dhëna me shkrim për vendimin e marrë** brenda një afati prej 30 (tridhjetë) ditësh pas përfundimit të shqyrtimit” (neni 3.2).
21. Siç u tha më lart, parashtruesi pohon për shkelje të së drejtës së tij për gjykim të drejtë nga Bordi i Pavarur për Rishqyrtime dhe Gjykata Supreme kur e drejta e tij për t'u dëgjuar nuk ishte respektuar dhe vendimi nuk ishte arsyetuar.
22. Përveç kësaj, e drejta për dëgjim të drejtë, siç është mishëruar në tekstet kushtetuese dhe në nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe në nenin 31 të Kushtetutës së Kosovës, është e natyrës themelore për t'i mbrojtur të drejtat themelore.

¹¹ Fjala “Tribunal” e përdorur në nenin 6 (1) të Konventës Evropiane ose fjala ‘Gjykata’ e përdorur në nenin 31 (1) të Kushtetutës.

¹² [Regullorja Nr. 2005/17](#), 9 prill 2005, për shpalljen e Ligjit mbi administratën dhe procedurat tatimore të miratuara nga Kuvendi i Kosovës.

¹³ Neni 57.1 i Ligjit Nr. 2004/48 parashikon që “Bordi i Pavarur për Rishqyrtime i themeluar sipas Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut Nr. 2000/7 do të vazhdojë si Bord i Pavarur për Rishqyrtime sipas këtij ligji”.

¹⁴ Urdhëresa Administrative e UNMIK-ut Nr. 2000/7, e 12 prillit 2000.

23. Megjithatë, e drejta e qasjes në gjykatë nuk është e drejtë absolute. Në praktikën e vet gjyqësore, GJEDNJ ka konstatuar më tej se çdo kufizim do të jetë në përputhje me nenin 6 nëse ndjek një synimin legjitim dhe nëse ka marrëdhënie të arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet masave të zbatuara dhe synimit që kërkohet të arrihet¹⁵. Prandaj, çdo kufizim duhet të jetë subjekt i parimeve të nevojës dhe proporcionalitetit, domethënë vetëm nëse është e nevojshme dhe gjersa të jetë e nevojshme.
24. E drejta themelore për gjykim të drejtë buron nga e drejta themelore për mbrojtje gjyqësore¹⁶. Më tepër se të drejtat e tjera themelore, e drejta për gjykim të drejtë kërkon që gjyqtarët të jenë të kujdesshëm pasi ata gjithnjë janë në rrezik për ta shkelur atë. Të gjithë gjyqtarët e gjykatave më të larta gjithashtu duhet të kontrollojnë që ky parim është zbatuar drejt në nivele më të ulëta. Në të vërtetë, e drejta për gjykim të drejtë është aludim i përgjithshëm për një sërë të drejtash të tjera: pra, e të drejtës për të paraqitur argumente dhe prova, e të drejtës për vendim të arsyetuar, dhe e parimit akuzator dhe barazisë së armëve.
25. Neni 31 i Kushtetutës dhe neni 6 i Konventës kërkojnë nga gjykatat vendëse që të japin arsye për aktgjykimet e veta. Gjykatat nuk janë të obliguara të japin përgjigje të hollësishme për çdo argument apo pyetje¹⁷. Megjithatë, nëse parashtresa është e rëndësishme për përfundimin e rastit, atëherë gjykata duhet ta trajtojë atë në mënyrë specifike dhe të qartë në aktgjykimin e vet.
26. Në *Hiro Balani kundër Spanjës*¹⁸, parashtresë ka dorëzuar një parashtresë në gjykatë, e cila kërkonte përgjigje specifike dhe të shpejtë. Gjykata dështoi ta ofronte atë përgjigje duke pamundësuar të konstatohej nëse thjesht e kishin shpërfillur trajtimin e kësaj çështjeje apo synonin ta hidhnin poshtë dhe nëse po, cilat ishin arsyet për ta hedhur atë poshtë. GJEDNJ konstatoi që kjo ishte në kundërshtim me nenin 6 (1).
27. Sipas mendimit tonë, është e padiskutueshme që argumenti mbi “metodën e përcaktimit të qarkullimit shtesë dhe obligimeve që dalin deri tani, duke pohuar që nuk janë marrë parasysh as argumentet që janë bindëse” as provat mbështetëse, është i rëndësishëm për përfundimin e atij rasti. Fakti që “vlerësimi i inspektorëve kontrollues nuk ishte i drejtë sepse sipas të

¹⁵ Ashingdane kundër Mbretërisë së Bashkuar, 28 maj 1985, par. 57.

¹⁶ Neni 54 i Kushtetutës.

¹⁷ Van de Hurk kundër Holandës, 19 prill 1994, par. 61.

¹⁸ *Hiro Balani kundër Spanjës*, 9 dhjetor 1994.

dhënave në dosje ishin deklaruar më tepër mallra se që ishin në dispozicion në stok”, është gjithashtu i rëndësishëm për përfundimin e atij rasti.

28. Përveç kësaj, asnjë përgjigje specifike dhe e shpejtë për argumentin e ngritur dhe provat e paraqitura nga parashtruesi nuk ishte ofruar as në vendimin e dytë të Bordit të Pavarur për Rishqyrtime as në aktgjykimin e dytë të Gjykatës Supreme. Prandaj, ishte e pamundur që parashtruesi “të konstatoje nëse thjesht e kishin shpërfillur trajtimin e kësaj çështjeje apo sinonin ta hidhnin poshtë dhe nëse po, cilat ishin arsyet për ta hedhur atë poshtë”.
29. Në parim, kërkesa kundër një gjykate të rregullt është e pranueshme nëse parashtruesit i ishte mohuar mundësia për t’u dëgjuar para gjykatës për shkak të një procedure të padrejtë nga gjykatat e rregullta gjatë procedurave.
30. E drejta për gjykim të drejtë është e drejtë që u përket gjyqtarëve kushtetues¹⁹, jo vetëm pse ata janë të thirrur ta shqyrtojnë pajtueshmërinë e gjykatave të rregullta me këtë parim kushtetues, por për shkak se e kanë për detyrë ta zbatojnë të drejtën për dëgjim të drejtë.
31. Supozojmë që sa më shumë mundësi që të kenë palët për t’i paraqitur argumentet e veta në mënyrë të barabartë, duke respektuar barazinë e armëve dhe parimet akuzatore, aq më tepër do të ketë gjasa që vendimi të jetë i drejtë. Me fjalë të tjera, në përpjekjet për të përcaktuar nëse gjykimi ka qenë i drejtë, nuk duhet ta shqyrtojmë substancën e vetë vendimit por mënyrën si ishte marrë vendimi.
32. E drejta për ta marrë vendimin e gjykatës në përputhje me ligjin përfshin obligimin e gjykatave për t’i ofruar arsyet për vendimet e tyre me shkaqe të arsyeshme në dy nivelet, atë procedural dhe material. Ofrimi i arsyeve kërkon sqarime me arsye bindëse dhe ligjërish të konstruktura për vendimin e marrë në secilin rast individual, i cili duhet t’i përfshijë kriteret ligjore dhe elementet faktike në mbështetje të vendimit.

¹⁹ Gjykata Evropiane, në rastin Kraska kundër Zvicrës, 19 prill 1993, para. 26, ka theksuar se neni 6 zbatohet për procedura para një gjykate kushtetuese nëse përfundimi i këtyre procedurave ndikon drejtpërdrejt në një të drejtë apo obligim civil.

33. Paraqitja e arsyeve nuk duhet, në asnjë mënyrë, të jetë tepër e gjatë, por duhet t'i mundësojë personit të cilit i dedikohet, dhe publikut në përgjithësi, ta përcjellë arsyetimin që e shpuri gjykatën ta merrte një vendim të veçantë. Për më tepër, e drejta për ankesë mund të jetë më efikase nëse faktet janë të përcaktuara mirë dhe arsyet për atë vendim janë të sqaruara në mënyrë të mjaftueshme.
34. Prandaj, arsyetimi i vendimit duhet ta theksojë marrëdhënien ndërmjet gjetjeve meritore dhe pasqyrimeve me rastin e shqyrtimit të provave në njërën anë, dhe konkluzioneve ligjore të gjykatës, në anën tjetër. Aktgjykimi i gjykatës do ta shkelë parimin kushtetues të ndalimit të arbitraritetit në vendimmarrje, nëse arsyetimi i dhënë nuk i përmban faktet e përcaktuara, dispozitat ligjore dhe marrëdhënien logjike ndërmjet tyre.
35. Prandaj, konsiderojmë që ka pasur shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë në vendimin e një gjykate të rregullt në të cilin është gjetur arbitraritet apo paarsyeshmëri. Si rrjedhojë, aktgjykimi i Gjykatës Supreme, në të cilin nuk e kontrolloi pohimin faktik në bazë të arsyeshme, duhet të shpallet i pavlefshëm. Aq më tepër, aktgjykimi mund të konsiderohet të kthehet mbrapsht në rast të arbitraritetit, domethënë pas mungesës ose vlerësimit të paarsyeshëm të provave esenciale.

(c) Konkluzioni që është dashur të arrihej

36. Para arsyeve të mëparshme, ne konsiderojmë që vendimet e kontestuara kanë shkelur të drejtën për gjykim të drejtë në kuptimin që:
- i. Ato nuk morën parasysh argumentet themelore dhe esenciale të ngritura dhe provat përkatëse e esenciale të paraqitura nga parashtruesi, pasi nuk e peshuan rëndësinë e tyre për këtë rast dhe nuk morën qëndrim lidhur me deklaratat përkatëse;
 - ii. Ato shkelën barazinë e armëve dhe parimet akuzatore, pasi nuk i kanë shqyrtuar barabar të gjitha argumentet e të dy palëve; dhe
 - iii. Ato janë pa arsye të mjaftueshme.

37. Shkurt, ka prova në rastin në fjalë që Gjykata Supreme, në aktgjykimin e vet të dytë dhe të fundit, nuk ishte konsekuente dhe e drejtë me rastin e vlerësimit të argumentit fillestar dhe provave të paraqitura nga parashtruesi dhe, si rrjedhojë, ka pasur shkelje të së drejtës së parashtruesit për gjykim të drejtë, siç parashihet me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të Konventës, të cekur më lart, dhe, për këtë arsye, me respekt nuk pajtohem.
38. Si rrjedhojë, në përputhje me rregullin 74 të Rregullores së punës, aktgjykimi i Gjykatës Supreme është dashur të shpallej i pavlefshëm dhe rasti është dashur t'i kthehej Gjykatës Supreme për rishqyrtim.

Almiro Rodrigues

Gjyqtar

Gjyljeta Mushkolaj

Gjyqtare

